

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7318 E martë 10 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje

në "Der Standard"

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje, gjatë një interviste për gazetën austriake "Der Standard", se ende nuk ka një datë për çeljen e negociatave për vendin tonë...

Vijon në faqet 20-21

Nga ADELHEID WOLFL

Vetingu, Rama: Një pjesë e konsiderueshme e njerëzve të drejtësisë do të pushohen



Opinion

Ditës

Nga TRITAN SHEHU

Raporti i vëzhguesve të Asamblesë Parlamentare të KiE, ashtu si edhe raporti final i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të 2017-ës, kanë konstatuar ...

Vijon në faqen 21

Qeveria nuk ka vullnet për zgjedhje të lira



Ngjarja në Malajzi, prangosjet e reja

Pedagogu i arrestuar për terrorizëm, nëna: Është kurth

Myftiu Agim Duka: Klodian Zaimi nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë lidhje me Myftininë e Elbasanit

Nga FATMIR POPJA

Arrestimi në Malajzi i Klodian Zaimit, i cili njihet dhe me emrin fetar Ibrahim dhe që dyshohet se rekrutonte të rinj për t'iu bashkuar organizatës terroriste ISIS, ka shokuar familjen e tij në Cërrik. Tejet ...

Në faqen 11

"DEBAT KONSTRUKTIV PER REFORMEN ZGJEDHORE, SI DO PERZGJIDHEN DREJTORET"

ZBARDHEN POROSITE E RAMES PER GRUPIN E PS

Kryeministri: AKU, vatër gjobëvëniesh, një pjesë e drejtorëve të ikin vetë. Reagon ish-drejtori Sejko: S'patëm mbështetje. Takimi me Nanon në Shkodër



(Në foto) Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

Në faqet 2-3

"NA KE PERBALLE"

Basha: 60 minuta seancë për pyetjet ndaj ministrave, çfarë u vendos

Në faqen 5

DETAJET ME ITALINE

Goli i arbëreshit Kandreva thyen Shqipërinë në "Loro Boriçi"

Në faqen 22

SHIFRAT

Dhuna në familje, 3.900 raportime, Tirana zë vendin e parë në vend

Në faqen 8

LISTA E PERDITUSUAR

Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës

Në faqet 18-19

FLASIN TE PREKURIT



Ja sa rritet masa e përfitimit për invalidët dhe të verbrit

Në faqen 13

Përkujtimorja e 70-vjetorit të ekzekutimit të "grupit të deputetëve"

Letrat nga populli: Të varen, të rrojë shoku Enver

Autoriteti i Dosjeve: Ja 31 të dënuarit. Dervishi: Tortura e manipulim

Nga FATMIRA NIKOLLI

Para së gjithash jetë të gjatë Shokut Enver dhe Partisë Komuniste. Telegramet të shkurtër, letra të gjata, pas një analize (1) të detajuar të "krimit" që kishte bërë grupi i deputetëve sabotatorë para 1947-ës, kërkojnë njëzëri, me



të njëjtën gjuhë e me të njëjtët terma, dënimin maksimal për tradhtarët e kombit. Në copa telegramesh që kanë ende kokën "Mbretinija Shqiptare", grupime lagjesh, qytetesh, vullnetarësh, profesionesh e zanatesh, drejtorish e studentësh, ...

Në faqet 14-15

GRUPI I PS EMERIMET

Grupi i PS do të përgatitet për debat me opozitën për reformën zgjedhore

Rama-deputetëve: Asnjë drejtor me mik, zgjedhje vetëm me konkurs

Porosia për të enjten, Balla: Debat konstruktiv

Darina Tanushi

Deputetët socialistë do të përgatiten për debat me opozitën, të enjten e seancës parlamentare, kur PD-ja pritet që të rimarrë çështjen e reformës zgjedhore. Në mbledhjen e radhës të Grupit Parlamentar të PS-së, ku morën pjesë edhe ministri dhe kryeministri Edi Rama, mësohet se kreu i qeverisë i ka porositur deputetët që të enjten të bëjnë një debat konstruktiv dhe të shmangen përplasjet me opozitën. Burimet bënë të ditur dje, se kryeministri ka porositur gjithashtu që të respektohet fryma e marrëveshjes së 18 majit, që do të thotë të trumbetohen konsensusi dhe fryma e bashkëpunimit me opozitën. "Debat konstruktiv. Shmangni përplasjen. Do respektojmë frymën e 18 majit për konsensus, bashkëpunim me opozitën", - është shprehur kreu i qeverisë, njëherësh edhe i PS-së, Edi Rama, në mbledhjen që zgjati për gati dy orë, në selinë e kryesisë së Kuvendit. Në mbledhje, edhe kryetari i grupit parlamentar, Taulant Balla ka sqaruar se, për reformën zgjedhore nuk është e nevojshme të ketë debat, por meqë PD-ja e ka kërkuar, deputetët duhet të jenë të përgatitur. Balla u ka kërkuar deputetëve që të mos mungojnë në seancë, kërkesë kjo e vazhdueshme e drejtuesve të grupit parlamentar socialist, për ligjëvënësit e majtë. Bashkëkryetari i Komisionit të Reformës Zgjedhore, Bledi Çuçi u ka kërkuar deputetëve socialistë gjithashtu që të përgatiten për debat ditën e enjte, duke shtruar piketat kryesore, bazuar në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.



Mbledhja e djeshme e Grupit Parlamentar të PS-së

DEKLARATAT



BLEDI ÇUÇI

Bashkëkryetari i Komisionit të Reformës Zgjedhore, Bledi Çuçi u ka kërkuar deputetëve socialistë gjithashtu që të përgatiten për debat ditën e enjte, duke shtruar piketat kryesore, bazuar në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.



DREJTORËT

Kryeministri Edi Rama u ka bërë të qartë deputetëve të tij se nuk do të pranjojë asnjë ndërhyrje për emërim drejtorësh. Në mbledhjen e djeshme të grupit, Rama mësohet të jetë shprehur se nuk do të ketë më emërimë partiake.



Ruçi e shtyu disa herë seancën, dhe në fund shtyu për këtë të enjte edhe miratimin e komisionit të reformës. Partia Demokratike kërkon që komisioni, me bashkëkryetarë Bledi Çuçin dhe Oerd Bylykbashin, të përbëhet nga 18 anëtarë, 9 nga të cilët do të vijjnë nga radhët e opozitës. Ndërsa, në bazë të marrëveshjes së 18 majit, PD-ja dhe PS-ja ranë dakord që të bashkëpunojnë për reformën kushtetuese, atë zgjedhore dhe çështje që kanë të bëjnë me integrimin e Shqipërisë. Një tjetër pikë diskutimi dje në mbledhje ishte ajo e ligjit për pakicat, ku ministri për Punët e Jashtme dhe Europën, Bushati ka theksuar dakordësinë me dy partitë e tjera dhe kalimin këtë javë në Kuvend.

DREJTORËT

Po ashtu, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste diskutoi këtë të hënë edhe për reformën në administratë. Kryeministri Edi Rama u ka bërë të qartë deputetëve të tij se nuk do të pranjojë asnjë ndërhyrje për emërim drejtorësh. Në mbledhjen e djeshme të grupit, Rama mësohet të jetë shprehur se nuk do të ketë më emërimë partiake. "Harrojmë emërimet e drejtoresh. Do të jenë me konkurs. Na propozoni emra, por po fitoi ndonjë tjetër më i mirë, mos më hyni mik. Rekrutojmë me parti, pasi të bëhen drejtorë pas konkursit", - iu ka thënë Rama deputetëve.

VIZITA

Kryeministri Edi Rama mësohet se në mesin e kësaj jave do të jetë për një vizitë në Itali, ndaj ka nxituar të zhvillojë këto dy ditë mbledhjen e qeverisë së bashku me zv.ministrat e rinj që sapo morën edhe miratimin të shtunën, në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare të PS-së.



Kryeministri Edi Rama gjatë prezantimit të djeshëm të drejtorit të ri të AKU-së, Agim Ismaili

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Taulant Balla, edhe në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të PS-së mbodhi dje paradite, në një takim të parë pas zgjedhjes, kryesinë dhe sekretariatit e partisë, në seli. Drejtuesit e PS-së kanë diskutuar në lidhje me procesin organizativ të PS-së, i cili tashmë ka hyrë në fazën intensive.

Ish-kryeministri, bashkë me djalin Sokolin në ekspozitën e "4 kupave"

Shqipëri-Itali bëjnë bashkë Fatos Nanon dhe Edi Ramën, në Shkodër

Kryeministri Edi Rama u shfaq dje, në prag të ndeshjes Shqipëri-Itali së bashku me paraardhësin e tij, ish-kryeministrin Fatos Nano. Të dy ishin të ftuarit e nderit në teatrin "Migjeni" të Shkodrës, në ekspozitën "4 herë Kampionë". Fatos Nano ka mbërritur i pari para teatrit "Migjeni". Ka rënë në sy fakti që Nano vazhdon t'i japë vetë makinën, pa shofer, por ndërkohë Nano ka qenë i shoqëruar me djalin e tij, Sokolin. Rama dhe Nano kanë shtrënguar duart para të pranishmëve. Ndërkohë, edhe në fillim të fjalës së tij përshëndetëse, Rama ka përmendur faktin që në atë sallë nuk ishte vetëm ai kryeministër. "Jemi dy kryeministra këtu, është edhe paraardhësi im, Fatosi". Shfaqja së bashku në publik e Nanos dhe Ramës mbërrin pas mbështetjes që ish-kreu i PS-së i bëri pasardhësit të tij në fushatë dhe



mesazhit që Nano u dërgoi drejtuesve aktualë të PS-së me rastin e përvjetorit të partisë, edhe pse vetë nuk mori pjesë në festime. Ndërsa, gjatë fjalës së tij Rama u shpreh se: "Në këtë qytet ka lindur skuadra e parë e futbollit. Këtu ka lindur skuadra e parë që quhej Juventus. Edhe kryetarja e bashkisë është krenare që po pret skuadrën italiane. Shumë

shqiptarë e duan kombëtaren italiane. Por nga ana tjetër luan dhe kombëtarja që është në zemrën e shumë shqiptarëve. Më kujtohet një banderolë ku shkruhej: 'Italia në zemër, Shqipëria dashuri'. Ne do të thërrasim për fitoren tonë sot. Duam që ju të mundni gjermanët në Rusi", - tha Rama.



Kreu i qeverisë prezanton drejtorin e ri të AKU, Agim Ismaili

Rama: AKU, vatër gjobëvëniesh, një pjesë e drejtorëve të ikin vetë

Ish-drejtori Sejko: Nuk patëm mbështetje nga qeveria

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama prezantoi dje, drejtorin e ri të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Agim Ismaili. Në fjalën e tij, kreu i qeverisë u kërkoi të largohen të gjithë drejtorët e AKU-së, për t'u provuar për detyrën që bëjnë. "Kemi një situatë praktikash absolutisht të papranueshme, absurde në tërësinë e tyre, që e kanë bërë këtë institucion një problem kombëtar", - u shpreh Rama që në fillim të fjalës së tij. "Ky është një institucion që vë gjoba, që i nxin jetën sipërmarrjes, që terrorizon dyqane dhe tregtarë të vegjël dhe që në fund fare nuk përmbush misionin e vet. Historitë e AKU-së në doganat e Shqipërisë janë të pafundme dhe, natyrisht, do të marrin fund njëherë e mirë, sepse AKU-ja nuk do të shkelë më nëpër dogana", - tha kryeministri.

"Besoj se të gjithë drejtorët e AKU-së duhet të rivihen në provë dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre duhet të ikin vetë. E dini vetë si keni ardhur, kush ju ka sjellë, pse ju ka sjellë dhe pse nuk mund të jeni drejtorë të AKU-së. Kjo është e vetëkuptueshme, kështu që s'ka nevojë ta zgjasim. Ndërkohë, ata që janë në këto pozicione si rezultat i arsimimit të tyre, si rezultat i profesionalizimit dhe eksperiencës së tyre, do të rivihen në provë dhe do të kenë gjithë kohën e nevojshme, por jo të pafundme, për të provuar që janë njerëzit e duhur në vendin e duhur", - tha më tej, kreu i qeverisë. "AKU-ja është një vatër e mbushur me korrupsion. Një vatër e infektuar nga korrupsioni dhe një vatër ku gjobëvënia për qëllime korruptive është standard. Sigurisht, unë nuk kam as ndërmend dhe as arsye të akuzoj drejtëpërdrejt askënd këtu prej jush, por ju e dini shumë mirë se për çfarë po flas dhe, natyrisht, edhe mesazhi ka protagonistë të këtij korrupsioni", - iu drejtua Rama drejtuesve të këtij autoriteti. Ai tha se, paralelisht me reformimin e këtij institucioni, brenda 100 ditëve në Republikën e Shqipërisë nuk duhet të ketë asnjë pikë gjaku në rrugë.



Kryeministri Edi Rama

ISH-DREJTORI I AKU

Pas deklaratave akuzuese të kreu të qeverisë, ish-drejtori i AKU-së, Dritan Sejko tha se kryeministri e ministri kanë informacione të pasakta. Sipas tij, kontrolli i AKU-së në dogana është një praktikë që e ka çdo vend, pasi në të kundërt do të kishim një kolaps sigurie ushqimore. Ai tha se synimi i AKU-së ka qenë sensibilizimi dhe jo ndëshkimi me gjoba.

Luan Rama: Mosfunksionimi i radarëve, dëgjesa me funksionarët e shtetit

Zëvendëskryetari i LSI-së, Luan Rama tha dje, pas Zëmbledhjes së Grupit Parlamentar të LSI-së, se grupi kishte mbështetur nisimën e tij për të nisur një cikël seancash dëgjimore në Komisionin e Çështjeve të Sigurisë dhe Mbrojtjes në lidhje me problemin e mosfunksionimit të radarëve. "Sistemi i radarëve që mbikëqyrin hapësirën detare të Shqipërisë nuk është operacional. Prej 2014-2015 ka dështim që ky sistem nuk ka funksionuar dhe Shqipëria si vend anëtar i NATO-s ka cenuar standardet e NATO-s. Në funksion të transparencës, unë do t'i propozoj Komisionit të Sigurisë një axhendë takimesh, seanca dëgjimore me të gjithë funksionarët e lartë shtetërore, titullarët e institucioneve që kanë përgjegjësi për garantimin e sigurisë kombëtare", - tha Luan Rama. Sipas tij, "duhej të ishte nisur një investim ligjor nga Prokuroria".

Vasili: Kryeministër qesharak, do "rënojë të varfrit që të varfërojë oligarkët"

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili e cilësoi "qesharak" kryeministrin dje, pas deklaratave që ai bëri në lidhje me taksat. "Kryeministri na la, dëgjoni ç'thotë: 'Do të rrënoj të varfrit, që të varfëroj oligarkët'. Pupu ç'kryeministër qesharak është ky! Nga Lezha tha: 'Po ia vë TVSH-në biznesit të vogël që të mos fitojnë oligarkët'. Domethënë: 'Do shkatërojmë të varfrit, që të varfëroj më të pasurit', thotë ky kryeministri ynë i paditur gjer në dhembje. Një budallallëk të tillë kolosal vetëm ai mund ta thotë", shkroi Vasili në një status në "FB". "Ngaqë është shkollëpakët, e tallin edhe ministrat e tij dhe i thonë fjalë dhe shpjegime, që ai dihet që nuk i merr vesh fare dhe vetëm i përsërit si papagall i varfrit, se ai vetë nuk lexon e nuk kupton gjë prej gjëje. Telekomandën e shkollëpakut e kanë oligarkët në dorë, por këta të fundit u treguan më të sinqertë dhe dolën sot paradite dhe deklaruan me gojë plot se janë shumë të lumtur me TVSH-në, që shkollëpakut po u vë bizneseve që luftojnë për bukën e gojës", shkroi Vasili.



Kryebashkiaku i Lezhës-kryeministrit: Në vendin tënd do të doja Bashën

Kreu i qeverisë: TVSH-ja e biznesit do të shkojë për investime, jo në xhepa

Qeveria ka vendosur të mos e ndalë aksionin kundër informalitetit në biznese. Gjatë konsultimit për Buxhetin 2018 në qytetin e Lezhës, kryeministri Rama sqaroi sërish çështjen e TVSH-së të bizneset. "Kemi nisur operacionin për ta çuar në një fazë të re luftën kundër informalitetit. Ajo çka nuk është normale është se beteja kundër reformës nga opozita bëhet me argumente katastrofike: 'Do mbyllen kaq biznese në ditë', 'Do bëhet hataja' etj. Njësoj siç bëhej kur do zbatohesh reforma në arsimin e lartë. Ne do ta çojmë deri në fund këtë reformë për më shumë të ardhura dhe për më shumë investime. Është e papranueshme që, një pjesë e të ardhurave që duhet t'u shkojë mbrapsht njerëzve përmes



TVSH-së, përfundojnë në xhepin e një grushti të pa-surish. Ne përpigemi të bëjmë politika të drejta, dhe jo politika që mbështesin të fortë ndaj të varfërve, apo kompanitë e mëdha në dëm të biznesit të vogël apo të konsumatorëve. Ata që e mbështesin sot, janë bërë mburojë e informalitetit", - u shpreh Rama. Kreu i qeverisë

sqaroi se biznesi i vogël e ka taksën zero deri në një kufi të caktuar, ndërsa ka shtuar se, tatimi mbi të ardhurat personale në shtet dhe privat nuk do të ndryshojnë. Në dëgjësën publike të kryeministrit Edi Rama në Lezhë mer-te pjesë edhe kryebashkiaku demokrat Fran Frrokaj, i cili u shpreh se bashkia e drejtuar prej tij do bashkëpunojë me qeverinë nëse reformat rezultojnë të suksesshme. Frrokaj i është drejtuar Ramës se do donte që të ishte Lulzim Basha në vendin e tij, por ky ka qenë verdikti i qytetarëve në 25 qershor: "Unë do të doja të ishte Lulzim Basha i ulur në vendin tuaj, por verdikti i qytetarëve ky është", - ka thënë Frrokaj. Ai i ka kërkuar Ramës investime për disa projekte infrastrukturore.

"Therje në rrugë nuk mund të ketë më. Jemi vetmi vend në kontinent që ther në rrugë", - tha Rama. "Mbyllja e të gjitha thertoreve që janë jashtë standardeve dhe që therin në rrugë është plani prioritar i AKU-së për këto 100 ditë", - u shpreh Rama. "Por, shtoi ai, - për çdo gjobë që do të vendoset, duhet të ketë një argumentim shumë të qartë, përndryshe kush vë gjobë, do të largohet menjëherë nga puna, në qoftë se nuk argumentohet siç duhet. Është e papranueshme një institucion gjobash".

Nga ana e tij, ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi deklaroi se brenda 100 ditëve do të mbyllen të gjitha thertoret e paligjshme, ndërsa kontrolli do të jetë i imtësishtëm. "Në rast se zbulohet një falsifikim apo thertore e paautorizuar, do shkojmë dhe do t'i gjejmë kush është

burimi dhe do të ketë ndëshkim. Thertjet në rrugë, që janë mesjetare, do të mbyllen me urgjencë brenda planit tonë 100-ditor. Ne do të propozojmë që thertoret që iu duhet pak më shumë investim do të mbështeten edhe nga shteti", - tha Peleshi. Ndërkohë, ish-drejtori i AKU-së, Dritan Sejko u shpreh se kryeministri dhe ministri kanë informacione të pasakta.

INTEGRIMI STANDARTET

'Manipulimi i zgjedhjeve', Shehu: Shitblerje votash me një grup të gjerë kriminal

Asambleja e KiE diskuton '25 qershorin': Liderët të dialogojnë, jo konfrontim

Bushati: Zgjedhjet, sipas standardeve të OSBE/ODIHR-it

Valentina Madani

Manipulimi i zgjedhjeve të 25 qershorit, shitblerja e votës dhe ndikimi i grupeve kriminale ditën e zgjedhjeve u denoncuan dhe nga opozita në sallën e KiE, ndërkohë që mazhoranca i cilësoi ato sipas standardeve të OSBE/ODIHR-it. Por delegacioni i Asamblesë Parlamentare të KiE doli dje në përfundim se kandidatët në zgjedhjet parlamentare në Shqipëri 25 qershor 2017 kanë bërë fushatë lirisht dhe të drejtat themelore, si e drejta për miting dhe liria e shprehjes, janë respektuar. Procesi zgjedhor është zhvilluar në mënyrë të rregullt, pa incidente serioze, përveç disa rasteve të izoluar të dhunës. Gjatë fushatës zgjedhore ka ekzistuar një klimë serioze mosbesimi mes partive kryesore politike. Kjo është influencuar nga kriza politike që nisi në vitin 2016, i ndjekur nga bojkoti i opozitës në parlament dhe kërcënimi i saj për bojkotimin e zgjedhjeve. Delegacioni i Asamblesë Parlamentare konsideron se liderët e partive kryesore politike duhet të fokusohen në rritjen e kulturës së dialogut dhe jo të konfrontimit. Në lidhje me këtë, asambleja mirëpriti marrëveshjen më 18 maj mes liderëve të partive kryesore politike, që mundësoi futjen e opozitës në zgjedhje. Asambleja është informuar nga përfaqësues të partive politike për shitblerje votash, për presion mbi votimin. Në raport përmendet edhe konstatimi i disa parregullsive, si për shembull në procesin e numërimit të votave. Në raport përmendet edhe konstatimi i disa parregullsive, si për shembull në procesin e numërimit të votave. "Shqipëria duhet të ndërhyjë në Kodin Zgjedhor përmes reformës", thuhet më tej. Tritan Shehu, deputet i PD-së, foli mbi problemin e manipulimit të zgjedhjeve në Asamblye të Këshillit të Europës, ku ndër të tjera theksoi se shitblerja e votave është bërë me një grup të gjerë kriminal. "Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë kon-



TRITAN SHEHU

"Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë konstatuar shitblerje masive të votës nëpërmjet përdorimit të parave kriminale që vijnë nga trafiqet e drogës dhe korrupsioni galopant. Shpesh, ky fenomen është përdorur për të supresuar pjesëmarrjen në votim të votuesve të opozitës, kundrejt marrjes me anë të pagesës të dokumentit të identitetit", - tha Shehu.

Kreu i Kuvendit takon Drejtorin për Zgjerimin Danielsson: Shqipëria në BE duke përmbushur detyrimet

Kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi priti dje, Drejtorin e Përgjithshëm për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit në Komisionin Evropian, Christian Danielsson. Ruçi u ndal në veprimtarinë parlamentare të kësaj legjislature, duke nënvizuar hapat e hedhur në drejtim të konkretizimit të Reformës në Drejtësi, përmes miratimit të strukturave dhe organikës të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ruçi vuri në dukje se Kuvendi shumë shpejt do të



konkretizojë edhe ngritjen e Komisionit Ad Hoc për Reformën Zgjedhore. Ai bëri me dije se, aktualisht Kuvendi po shqyrton dhe do të miratojë së shpejti ligjin për pakicat kombëtare, i cili ka kaluar procesin e konsultimit me sho-

qërinë civile dhe është miratuar në dy komisione parlamentare. Drejtori i Përgjithshëm për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit në Komisionin Evropian, z. Christian Danielsson, vuri në dukje mjedisin pozitiv në Europë për pranimin e Ballkanit Perëndimor si pjesë e saj dhe se Shqipëria duhet të përfitojë nga kjo mundësi, duke përmbushur rekomandimet e BE-së për hapjen e negociatave. Z. Danielsson theksoi rolin e Kuvendit në përballje me sfidat e integritetit, duke vlerësuar angazhimin dhe vullnetin e shprehur nga z. Ruçi në këtë drejtim.

statuar shitblerje masive të votës nëpërmjet përdorimit të parave kriminale që vijnë nga trafiqet e drogës dhe korrupsioni galopant. Shpesh, ky fenomen është përdorur për të supresuar pjesëmarrjen në votim të votuesve të opozitës, kundrejt marrjes me anë të pagesës të dokumentit të identitetit të nevojshëm për votim, duke penguar në thelb të drejtën për të votuar? Vëzhguesit

kanë konstatuar numër të lartë të presionit ndaj zgjedhësve për të marrë pjesë në fushatë dhe për të votuar në favor të partisë në pushtet, Partia Socialiste, nëpërmjet kërcënimit me humbje të vendit të punës në administratën publike. Për herë të parë këto kërcënime janë konstatuar edhe në sektorin privat. Kjo cenon standardin e lirisë për të votuar pa frikë nga reperkusionet",

- deklaroi deputeti i PD-së. Shehu akuzoi se "qeveria socialiste nuk ka vullnet për të zhvilluar zgjedhje me standarde, sepse nuk do të fitonte në kushtet e korrupsionit, kriminalitetit dhe trafiqeve galopante të drogës. Në këto kushte, forci i monitorimit nga kjo Asamble e nderuar është themelor për rikthimin e bazave të demokracisë në Shqipëri". Edhe deputeti i PS-



Gjatë një seance parlamentare

ERVIN BUSHATI

"Zhvillimi i zgjedhjeve demokratike dhe arritja e tyre me standarde të larta evropiane ishte në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Zgjedhjet e përgjithshme të këtij viti u zhvilluan në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, standardet ndërkombëtare dhe legjislativon vendas, - cituar në Raportin Final të OSBE/ODIHR-it", - tha Bushati.

Takimi, Bushati: Shqipëria, arritje në procesin e integritetit

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati priti dje, Drejtorin e Përgjithshëm për Negociatat e Anëtarësimit në Komisionin Evropian, Christian Danielsson. Ministri Bushati informoi mbi arritjet më të fundit në procesin e reformave që lidhen me integritetin evropian. Danielsson vlerësoi vazhdimin e progresit të qëndrueshëm të Shqipërisë në zbatimin e prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Ai vlerësoi veçanërisht miratimin e reformës në drejtësi, duke theksuar njëkohësisht rëndësinë e progresit në zbatimin e saj. Danielsson vlerësoi linjizimin e politikës së jashtme të Shqipërisë me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian, si dhe rolin pro-aktiv të Shqipërisë për nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.



së, Ervin Bushati ishte i pranishëm në Asamblye Parlamentare të Këshillit të Europës. Në cilësinë e Kryetarit të Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Shqipërisë në Asamblye Parlamentare, Bushati foli për organizimin e zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit. Sipas Bushatit, zhvillimi i zgjedhjeve ishte në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it.

"Zhvillimi i zgjedhjeve demokratike dhe arritja e tyre me standarde të larta evropiane ishte në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Zgjedhjet e përgjithshme të këtij viti u zhvilluan në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, standardet ndërkombëtare dhe legjislativon vendas, - cituar në Raportin Final të OSBE/ODIHR-it", - theksoi z. Bushati.



Mbledhja e grupit, PD aktivitet intensiv parlamentar kundër qeverisë

Përkallëzim të aksionit në Kuvend, Basha-Ramës: Na ke përballë

60 minuta seancë të mërkurave, pyetje qeverisë

Valentina Madani

Opozita paralajmëron përkallëzim të aksionit parlamentar, duke kërkuar rikthimin e seancës plenare të pyetjeve për ministrat dhe kryeministrin. Grupi i deputetëve të PD-së vendosi dje intensifikim të jetës parlamentare, seancë pyetjesh me kryeministrin Rama dhe ministrat e tij dhe fokus total tek reforma zgjedhore. Kreu i PD-së, Lulzim Basha akuzoi se mazhoranca po tenton t'i mbyllë gojën opozitës, por nuk do t'ia dalë. Për këtë, Basha tha se do të intensifikojnë aktivitetin parlamentar, duke paralajmëruar rikthimin e praktikës së seancës së pyetjeve në Kuvend. Basha mësohet të jetë shprehur para deputetëve se do të kërkojnë që bazuar në rregulloren e Kuvendit të kthejnë praktikën e seancës së pyetjeve për të vënë para përgjegjësisë kryeministrin dhe ministrat e qeverisë "Rama 2". Kështu, opozita parashikon seancë 60-minutëshe çdo të mërkurë, përveç seancës së të enjtes. "Në vijim të ngjarjes së shëmtuar të javës së kaluar dhe të dy javëve të kaluara, ku Edi Rama përmes Gramoz Ruçit u mundua të dhunojë rregulloren për t'i mbyllur gojën opozitës. Kjo nuk ka për t'u pranuar kurrë dhe nuk do të ndodhë, e kundërta do të ndodhë. Ne do të intensifikojmë aktivitetin tonë parlamentar, duke rikthyer një praktikë konform rregullores, që është praktika e seancës së pyetjeve për të vendosur Edi Ramën dhe ministrat e tij para përgjegjësisë. Diçka prej të cilës po mundohet të largohet çdo ditë, duke dalë një ditë si bahçevan, një ditë si kopshtar. Paska hapur dhe Pallatin Mbretëror. Këtë rrit taksat, këtë më shumë bar për qytetarët. Sigurisht që nuk është as bahçevan dhe as kopshtar, është përgjegjësi për një Shqipëri të fundosur nga krimi, të vetmin vend që nuk i hapen negociatat, ndërkohë që Serbia dhe Mali i Zi ecin përpara me negociatat dhe në këto kushte ta harrojnë se me opozitën dhe PD do të ketë diçka tjetër përveç përballjes totale. Ai e ka zgjedhur kompromisin, kompromisin



Basha nënvizoi se pa rivendosur institucionin e zgjedhjeve, shqiptarët kurrë nuk do të kenë një qeveri që të mendojë për ta. "Theksi këtë javë mbetet tek zgjedhjet e lira dhe të ndershme, duket si përsëritje, por pa rivendosur institucionin e zgjedhjeve, shqiptarët kurrë nuk do të kenë një qeveri që të mendojë për ta. Do mendojë për ata që e sollën në pushtet. Edi Ramën e sollën në pushtet bandat, krimi, droga dhe paratë e drogës. Ky është haraçi që paguan çdo shqiptar nga mëngjesi deri në darkë sot, qoftë sa i përket përkeqësimit të qeverisjes, rritjes së taksave mungesës së shërbimeve nga shëndetësia tek arsimi, gjendjes së përgjithshme ekonomike të vendit që janë efekte të një qeverie që bashkëqeveris me krimin, një kryeministri që është rob i marrëdhënies korruptive me oligarkët. Në Shqipëri ka një paradoks, një grusht njerëzish pasurohen dhe vazhdojnë të pasurohen edhe në këto momente që flasim ne, ndërkohë që shumica e shqiptarëve duan të largohen. Themeli i kësaj të keqeje është një qeveri që nuk vjen nga zgjedhjet, pa rregulluar këtë themel, asgjë tjetër nuk do të shkojë mirë në shtëpinë tonë të përbashkët, që është Shqipëria", deklaroi z.Basha.

DEKLARATA

Burime nga mbledhja e grupit bëjnë me dije se z.Basha ka deklaruar se nuk ka konsensus të PD me qeverinë. "Nuk ka konsensus të PD me këtë qeveri, me këtë mazhorancë dhe me Edi Ramën. Rama është i sëmurë psikik. Duhet kundërshtuar dhe duhet komunikuar me publikun. Opozita është totalisht kundër kësaj qeverie, për jetë a vdekje, e keqja është gjithkund. Opozita është kundër gjithmonë", është shprehur Basha.



Ish-kryeministri Sali Berisha

Denoncimi tek ish-kryeministri

"Fabrika e përpunimit po na helmon fëmijët"

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje në faqen e tij të "Facebook"-ut një mesazh të qytetarit dixhital, ku ky i fundit denoncon një fabrikë të përpunimit të zorrëve në Lezhë. Në mesazhin e tij, Berisha, bazuar tek të dhënat e denoncuesit, theksoi se kjo fabrikë kundërmon erë të keqe, duke e bërë situatën të padurueshme për qytetarët. "Qytetari dixhital denoncon: fabrikën e përpunimit të zorrëve në Lezhë, që kundërmon erë të padurueshme! Sb Përsëhënde tje z.Berisha, uroj të jeni mirë me shëndet. Jam një banor i Lezhës dhe doja të ndaja me ju një shqetësim tepër serioz. Ne lagjen ish-ushqimorja 'Iliria' ndodhet një fabrikë përpunimi zorrësh, të cilat përdoren për sallam. Mbetjet e zorrëve që vijnë nga Kroacia, Mali i Zi, Serbia etj., bashkë me lëngun e tyre të qelbur hidhen në kanal natën vonë, ose dhe gjatë ditës dhe era e tyre përhapet në të gjithë lagjen, aq shumë sa s'mund të mbajmë dritaret hapur, sepse do marrim ndonjë sëmundje a kancer, po na helmojnë fëmijët sidomos, gjithashtu edhe të rriturit. Kemi bërë ankesa kudo në institucionet përkatëse. Kemi lajmëruar dhe mediat, por askush nuk do t'ia dijë, pasi pronari i kësaj fabrike thuhet se është ish-zv.ministri Alban Zusi. Do ju lutesha shumë ta publikoni, sepse s'po mund të rrimë dot dhe para 2-3 ditësh disa fëmijë të vegjël të kësaj lagjeje janë shtruar në Spitalin Rajonal të Lezhës për këtë problem që po na merr jetën. Respekto doktor!", thuhet në mesazhin dërguar z.Berisha.

VENDIMI

Z.Basha deklaroi se do të kërkojnë që bazuar në rregulloren e Kuvendit, të kthejnë praktikën e seancës së pyetjeve për të vënë para përgjegjësisë kryeministrin dhe ministrat e qeverisë "Rama 2". Kështu, opozita parashikon seancë 60-minutëshe çdo të mërkurë, përveç seancës së të enjtes.

e ka me krimin e organizuar, e ka me Sejdinët, jo vetëm në Elbasan, por anembanë Shqipërisë me Sejdinët e krimin dhe në këtë rreshtim është e qartë se Edi Rama ka vënë PS dhe qeverinë në funksion të aleancës me

krimin. Ne jemi në funksion të aleancës së vlerave me qytetarët dhe kjo do të shpallset në çdo aspekt të përballjes parlamentare", deklaroi z.Basha. Të enjten në parlament do të rikthehet debati për reformën zgjedhore.

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë

deutscher oktober
tëtori gjerman

INFO-TAG

Panairi i informacionit rreth Gjermanisë

Shkollime, studime, praktika, bursa, kërkim shkencor, mësimi i gjermanishtes, etj.

Kur? E premte, 13 tetor 2017
mund të vini të informoheni në çdo kohë nga ora 10:00 deri në 16:00

Ku? Rrjeti i Informimit të Bashkimit Evropian,
Blv. "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë.

Për informacione të mëtejshme vizitoni: www.tetori-gjerman.com

Study in Germany
Land of Ideas
www.study-in.de

DAAD
GOETHE-ZENTRUM
KOOPERATIONSPARTNER
GOETHE INSTITUT

Deutscher Akademischer Austauschdienst
German Academic Exchange Service
IPS
IPS
Institut für Internationale Politik und Systemforschung
www.ips-ggk.de

IPS
IPS
Institut für Internationale Politik und Systemforschung
www.ips-ggk.de

IPS
IPS
Institut für Internationale Politik und Systemforschung
www.ips-ggk.de

Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Vasilika Vjetro, e ftuar në studion e lajmeve në "News24" ka komentuar aksionin anti-informalitet dhe pse do bëhet pjesë e tij edhe biznesi i vogël. Ajo sqaroi se tashmë do të zhvillohet faza e tretë e këtij aksioni që fokusin kryesor e ka te biznesi i madh, por shtoi se pjesë e pashmangshme e kontrollit do jetë edhe biznesi i vogël, sidomos 17 mijë bizneset që i përkasin fashës së fitimit nga 5 deri në 8 milionë lekë xhiro. "Në fokus janë bizneset e mëdha, janë periodike dhe të vazhdueshme. Pastaj ka edhe kontrolle të thelluara. Duhet disa muaj që administrata e përgatit

Bizneset e vogla që nuk do të përfshihen në regjimin e TVSH

Ja bizneset e vogla që s'mund t'i shmangen kontrollit

AKSIONI

"Në fokus janë bizneset e mëdha, janë periodike dhe të vazhdueshme. Pastaj ka edhe kontrolle të thelluara. Duhet disa muaj që administrata e përgatit punonjësin, njofton edhe tatimpaguesin; janë kontrolle të orientuara. Pastaj kemi edhe kontrolle nga zyra që zhvillohen për një apo dy ditë. Gjithashtu janë edhe kontrollet e paparalajmëruara që shihen kuponit, fatura e mallit. Nëse do flasim lidhur me evazionin, vetëm

punonjësin, njofton edhe tatimpaguesin; janë kontrolle të orientuara. Pastaj kemi edhe kontrolle nga zyra që zhvillohen për një apo dy

ditë. Gjithashtu janë edhe kontrollet e paparalajmëruara që shihen kuponit, fatura e mallit. Nëse do flasim lidhur me evazionin, vetëm

17 mijë janë në fashën 5 deri 8 milionë. Pra, kjo është fasha që s'mund të mbetet e pakontrolluar", - tha Vjetro. Ndërkohë, dje ministri i Financave bëri të ditur listën e bizneseve të vogla që nuk do të përfshihen në TVSH. Zejtarët dhe tregjet e bashkive, janë dy kategoritë e bizneseve të vogla që nuk do të përfshihen në regjimin e TVSH-së. "Ne patëm një diskutim shumë të gjatë me kryeministrin për detajet,



Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Vasilika Vjetro

dhe kryeministri ka vendosur që logjika e TVSH-së për zejtarët dhe tregjet e miratuar të bashkive të jetë e përjashtuar, pra të mos aplikohet. Pra, për zejtarët me definicion, meqë nuk kanë inpute, dhe për treg-

jet e bashkive të vazhdojë siç ka qenë, pjesa tjetër pastaj shtrihet te 20 përqindësi", - deklaroi ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj, gjatë konsultimit publik me qytetarët e Lezhës.

"Institucioneve të rivlerësimit përfitojnë një rrogë mujore"

Ornela Manjani

Qeveria: Një pagë plus Anëtarëve të Vetingut

Efektet financiare nga fondi shtesë i buxhetit

Këshilli i Ministrave vendosi, përcaktimin e pagesës mujore shtesë për shkak të vështirësisë, për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit. Në vendim përcaktohet se, anëtarët e institucioneve të rivlerësimit përfitojnë një pagesë mujore shtesë për shkak të vështirësisë, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në pikën dy të vendimit përcaktohet edhe masa e shpërblimit. "Pagesa mujore shtesë për shkak të vështirësisë përllogaritet në masën 50% mbi pagën bruto fillestare për çdo anëtar të institucionit të rivlerësimit, sipas përkatësisë. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i përcaktuar për institucionet e reja të sistemit të drejtësisë", thuhet në vendimin e qeverisë. Ndërkohë që ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kolegji i Posaçëm i Apelitit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e emërimit të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit.

RRITJA

Qeveria ka vendosur që të rrisë me 50% pagat për të gjithë anëtarët e institucioneve të rivlerësimit. Vendimi u mor në mbledhjen e qeverisë dhe u bë publik nga ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj. Sipas saj, me rritjen e pagës shtesë dhe me vënien në dispozicion të infrastrukturës, institucionet e reja janë gati të fillojnë nga procesi që sot. "Qeveria shqiptare, ashtu siç ka premtuar se do të mbështesë zbatimin e reformës në drejtësi në aspektin buxhetor dhe atë infrastrukturor, me vendimin që mori sot, kon-



Qeveria "Rama 2"

PAGAT MILIONËSHE QË KËRKOJNË ORGANET E VETINGUT

- Komisionerët publikë, 52 anëtarë, pagë 10 mln lekë në muaj, fondi total 520 milionë lekë në muaj.
- Anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, 65 anëtarë, pagë 11 mln lekë në muaj, me një fond total 715 milionë lekë në muaj.
- Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 68 anëtarë, pagë 11 mln lekë në muaj, me një fond total prej 748 milionë lekësh në muaj.
- Në total kërkohen 1 miliard e 983 milionë lekë në muaj ose në vit 23 miliardë e 796 milionë lekë për të gjitha organet.

firmoi edhe njëherë angazhimin e saj serioz. Mbështetja nga ana e qeverisë për sa i përket buxhetit është një detyrim sa kushtetues edhe ligjor, aq sa edhe shprehja e një vullneti të plotë për rritjen e pagesës me 50% më shumë. Me vënien në dispozicion të godinave dhe infrastrukturës me miratimin e strukturës si dhe me shtesën e pagës që

iu vu sot të gjithë anëtarëve të komisionit të vetingut, institucionit e reja janë gati të fillojnë nga procesi që sot. Qeveria shqiptare është shumë e interesuar që procesi i vetingut të nisë sa më parë, proces për të cilin u punua gjatë për ta dizenuar dhe miratuar, proces nga i cili mezi pritët edhe nga qytetarët për të dhënë rezultatet e para", - tha Gjonaj.

VENDIMI

"Pagesa mujore shtesë për shkak të vështirësisë përllogaritet në masën 50% mbi pagën bruto fillestare për çdo anëtar të institucionit të rivlerësimit, sipas përkatësisë. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i përcaktuar për institucionet e reja të sistemit të drejtësisë"



Implemented by giz

ANNOUNCEMENT

Private Vocational Training Provider – Call for Proposal and Expression of Interest

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under the component of Technical Vocational Education & Training, will cooperate with Private Vocational Training providers in the country, with the aim to scale-up VET programs, complementary to the courses offered by Public VET providers. In this respect the programme is conducting a Call for Proposals and Expression of Interest from 26 September – 15 October 2017.

The Call for Proposals and Expression of Interest shall help to identify private entities that can offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- training/courses with 3 - 6 months training duration for about 50 - 150 participants, targeting young people at the age of 19-34 years. 40% of the participants are female and 30% of the trainees are young returning migrants from EU countries.
- demand-driven and work-based VT short-term courses relevant to the local labour market that lead to employment of the stated target group. The proposals should explain how employment of min. 50% of the participants after completing the training measure can be achieved.
- There is no limitation in terms of geographical location, though high preference will be given to the locations where available vocational training offer by either public or private VET providers is non-existent or very limited. The courses should be in line with the following prioritized sectors – ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear, innovative/creative crafts.

The 5-7 proposals that are to be selected through this call shall receive financial support in the amount between 30,000 – 50,000 EUR (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the programme budget of 250,000 EUR assigned for this activity is allocated. The project implementation timeframe is up to 1 year (12 months).

Selection Procedure:

First step: All Call for Proposals and Expression of Interest received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

Second Step: The potential qualified candidates will be invited for an interview and required to submit a budget proposal.

Third Step: Contracts will be awarded to the 5-7 companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive Expression of Interest format and Evaluation Grid.

For further questions, please, contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 26 September-14 October 2017.

Vendet vakante në 16 drejtori, dokumentet dhe afatet për të aplikuar

Legalizimet, vendet bosh dhe kriteret për punësim

Kushtet që duhet të përmbushin kandidatët, dokumentet dhe vlerësimi i testit

Ornela Manjani

A gjencia e Legalizimeve hap konkursin për punonjës të rinj në të gjitha qarqet e vendit. Ashtu siç ishte njoftuar edhe më parë nga kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame, tashmë të interesuarit për punë në Drejtoritë e Legalizimeve do t'i nënshtrohen konkursit, bazuar në ligj dhe udhëzimet përkatëse. Konkretisht, sot Drejtoria e Përgjithshme e Legalizimeve ka shpallur kriteret, vendet vakante dhe procedurën që ndiqet për vlerësimin e konkurrentëve. "Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 'Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar VKM Nr.289, datë 17.5.2006 'Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të zonave/ndërtimeve informale (ALUIZNI)', pika 7, shpallet konkurrimi për pozicione vakante në Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t: Tiranë, Durrës, Berat, Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Sarandë, Shkodër, Vlorë", - bëjnë të ditur burime zyrtare pranë ALUIZNI-t. Sipas institucionit, vendet vakante janë hapur për përgjegjës sektori: Kategoria: IV-a, niveli minimal i diplomës 'Master shkencor'; specialist, kategoria: IV-b, niveli minimal i diplomës 'Bachelor'.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet, si më poshtë:
 - a) Letër interesi për pozicionin për të cilin është i interesuar kandidati.
 - b) Jetëshkrim (CV).
 - c) Fotokopje të diplomës dhe listës së notave, (përfshirë edhe diplomën 'Bachelor' kur kërkohet diploma 'Master Shkencor'). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit.
 - d) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
 - e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
 - f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
 - g) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore/ formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore.
 - h) Të paktën dy referenca të punëdhënësit të mëparshëm.
 - i) Adresën e saktë të vendbanimit, e-mail dhe kontakt telefonik.
 - j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet nëpërmjet postës zyrtare, apo dorazi në Zyrën e Protokollit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, ose në adresën elektronike të ALUIZNI-t, info@aluzni.gov.al

Dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet brenda datës: 02.10.2017.

KUSHTET DHE KRITERET E KONKURRIMIT

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme, si vijon: Të zotë-rojnë diplomë të arsimit të lartë, nivelin minimal "Bachelor" në profilin Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturi, Urbanistikë, Gjeoinformatikë, Gjeodezi, Topografi). Për pozicionin 'përgjegjës sektori', kandidatët duhet të zotë-rojnë

diplomë të nivelit minimal "Master shkencor" në profilin e mësipërme, si edhe Juridik. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. Për pozicionin "specialist", kandidatët duhet të kenë të paktën 2 vite përvojë pune në profesion. Për pozicionin 'përgjegjës sektori', kandidatët duhet të kenë të paktën 3 vite punë në profesion. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore gjatë vitit të fundit. Preferohet të kenë trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse. Të kenë njohuri të gjuhës angleze, ose të një gjuhe tjetër të BE-së.



Foto ilustruese

VLERËSIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do t'u nënshtrohen procedurave të mëtejshme të vlerësimit nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë.
- b - Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 30 pikë. Gjatë intervistës do të vlerësohen në lidhje me: Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionet për të cilat aplikojnë. Eksperiencën e tyre të mëparshme si dhe motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën).
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 30 pikë.

Shpallja e rezultateve të konkurrimit

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail të paraqitur në dokumentacionin e aplikimit).

Raporti i Bankës së Shqipërisë

Ndërtimi rrit besimin në ekonomi, dobët industria dhe shërbimet

Besimi në ekonomi është rritur në tremujorin e tretë pas rënies në tre muajt e mëparshëm, duke reflektuar pritshmëritë pozitive të sektorit të ndërtimit dhe konsumatorëve. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) shënoi rritje me 1.8 pikë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2017, duke qëndruar në nivelin 113.8, raportoii Banka e Shqipërisë. Ky nivel i TNE-së mbetet mbi mesataren afatgjatë të treguesit dhe mbi vlerën e tij në të njëjtin tremujor një vit më parë. Rritja e TNE-së reflektoi përmirësimin e besimit të bizneseve të tregtisë e ndërtimit dhe besimit të konsumatorëve. Ndërkohë, nivelet e treguesve të besimit në shërbime dhe në industri rezultuan lehtësisht më të ulëta, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Treguesi i besimit në sektorin e industrisë (TBI) shënoi rënie të lehtë me 1.0 pikë përqindje gjatë tremujorit të tretë të vitit 2017. Megjithatë, TBI-ja vazhdon të qëndrojë 10.9 pikë përqindje mbi mesataren historike të tij. Rënia e TBI-së u përcaktua kryesisht nga ecuria e bal-



torike të saj. Treguesi i besimit në sektorin e ndërtimit (TBN) vijoi të shënojë rritje për të tretin tremujor radhazi (+7.2 pikë përqindje). Kjo tendencë e ka zhvendosur treguesin me 8.5 pikë përqindje mbi mesataren historike të tij (grafik 2). Ecuria e TBN-së pasqyroi rritjen e të dy komponentëve të tij: balancës së aktivitetit ndërtues (+9.9 pikë përqindje) dhe balancës së kontratave porositëse (+4.4 pikë përqindje). Balancat e tjera të vërtetimit që nuk përfshihen në gjenerimin e TBN-së, si ajo e punësimit dhe e gjendjes financiare, me gjithë rënien e lehtë të shënuar analizën e tremujorit mbetet mbi nivelet e njëjti më parë. Për sa u takon pritjeve për punësimin në tremujorin e ardhshëm, ato rezultuan më të përmirësuar. Ndërkohë, norma e shfrytëzimit të kapaciteteve qëndroi rreth 62.9%, pothuajse sa norma mesatare e shënuar gjatë gjysmës së parë të vitit. Megjithatë, kjo normë mbetet 1.2 pikë përqindje nën mesataren historike të saj.

Sejko me ambasadorin francez

"Rëndësi, investimet e huaja dhe shkëmbimet tregtare"



Gjenerali i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko gjatë takimit të parë zyrtar me ambasadorin e re të Republikës Franceze, prezantoi zhvillimet ekonomike në vend, ku u shpreh se politika monetare lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka ndihmuar duke influencuar pozitivisht në trajektoren e zhvillimit ekonomik, në qëndrueshmërinë e çmimeve të konsumit, si dhe në stabilitetin financiar të vendit. Më tej, guvernatori Sejko e njohu ambasadorin zj. Christina Vasak me zhvillimet financiare në vend, me fokus të veçantë në sektorin bankar. Guvernatori Sejko theksoi se sistemi financiar karakterizohet nga nivele të kënaqshme kapitalizimi dhe likuiditeti. Në panoramën e sektorit bankar, guvernatori Sejko veçoi përmirësimin e treguesit të kredive me probleme, duke u shprehur se plani ndërinstitucional i ndërmarrë i ka dhënë efektet e tij, duke bërë që raportin e tyre ndaj kredisë totale të zbrësë në nivelin më të ulët

që prej vitit 2011. Në vijim bisedat u përqendruan në marrëdhëniet ekonomike dypalëshe si dhe në rëndësinë e promovimit të potencialëve të vendit tonë. Nga ana e saj, zj. Christina Vasak vlerësoi rolin e rëndësishëm që ka Banka e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian nëpërmjet kontributit të dhënë në përafrimin e kuadrit rregullator me standardet e BE-së.

KRIMINALITETI SHIFRAT E FRIKSHME

"Në total, 5.946 të burgosur për vepra të ndryshme penale, Kukësi me numrin më të ulët"

Dhuna në familje, Tirana zë vendin e parë


INSTAT: Në vitin 2016, krahasuar me 2015 kemi 7,3% kallëzime më shumë

Ina Allkanjari

Ritit numri i raportimeve për dhunë në familje, ku Tirana dhe Durrësi janë qarqet që rezultojnë me numrin më të lartë të kallëzimeve. Pavarësisht vështirësisë së matjes së këtij fenomeni, instituti i statistikave raporton se nga viti 2015 deri në 2016-ën pasqyrohen 252 kallëzime më shumë në rang vendi. Ndërkohë, në total në rang vendi në 2016-ën numërohen 3.900 raportime të dhunës në familje. INSTAT-i pasqyron gjithashtu të dhëna mbi autorët e veprave penale si dhe të burgosurit në nivel qarqiu. Vihet re një rritje prej 30,6% në numrin e të burgosurve në vitin 2016 në krahasim me 2012-ën. Ndërkohë, qarqet me numrin më të lartë të tyre janë Lezha, Tirana dhe Vlora. Mësohet se burimi i informacionit për statistikën e pasqyruar është siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

DHUNA NË FAMILJE

Dhuna në familje përbën një fenomen shqetësues dhe gjendet në të gjitha kulturat, duke ndikuar negativisht në integritetin fizik, psikosocial dhe ekonomik të personit ndaj të cilit ushtrohet dhunë. Instituti i statistikave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka pasqyruar të dhënat mbi normën e ndryshimit në numrin e raportimeve të dhunës në familje si dhe të dhënat mbi të miturit dhe femrat të prekur nga ky fenomen. INSTAT-i sqaron, se është e vështirë të matet niveli për përhapjen e dhunës në familje, pasi ky fenomen konsiderohet si çështje familjare. Instituti i statistikave thekson, se si rrjedhojë, ndër faktorët që mund të ndikojnë në raportimin e ulët të dhunës në familje, mund të përmenden turpi, frika nga ndëshkimi, normat kulturore dhe stereotipat që ekzistojnë për dhunën në familje. Të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë tregojnë se në vitin 2016, duke e krahasuar me 2015-ën, kemi 7,3%



172 raste për shitje dhe prodhim të lëndëve narkotike

Gjykata e Tiranës: 2.097 çështje për gjykim, dhuna në familje zë vendin e parë

Shkon në 2.097 numri i çështjeve penale për gjykim, një shifër e publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Tiranës. Të dhënat e pasqyruara përfshijnë një rang kohor nga 1 janari i 2017-ës deri në 9 tetor. Ndërkohë, nga numri total i sipërpërmendur që shkon në 2097 çështje penale për gjykim, vihet re se 1.466 prej tyre janë çështje të ardhura të reja. Rastet e prekura në këto statistika përfshijnë krime të ndryshme, si: vrasje, plagosje, marrëdhënie seksuale



me dhunë ose kundrejt të miturve, ngacmime seksuale, prostitucion, dhunë në familje, vjedhje, mashtrime, prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike etj. Vihet re se numrin më të lartë të çështjeve për gjykim e prek "Dhu-

na në familje", me një total prej 346 rastesh. Çështja penale e cila zë vendin e dytë në klasifikim për numrin më të lartë të rasteve është "prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", me 172 çështje për gjykim.

TË MITURIT DHE FEMRAT TË PREKUR NGA DHUNA

Në Shqipëri, në vitin 2016 të miturit zënë 3,6% në totalin e gjithë personave të dhunuar, ose, shprehur në terma absolutë, numërohen 133 të mitur të prekur nga ky fenomen. Për sa i përket dhunës së ushtruar ndaj femrave, në rang vendi numërohen në terma absolutë 2.825 femra që raportojnë dhunën në familje në vitin 2016, të cilat përbëjnë rreth 76% të të gjithë personave të dhunuar.

raportime më shumë. Në total në rang vendi në 2016-ën numërohen 3.900 raportime të dhunës në familje. Përqindja më e lartë e denoncimeve vihet re në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit, dhe më e ulëta në qarkun e Di-

brës dhe të Kukësit. Nga shifrat e pasqyruara vihet re se norma e ndryshimit në numrin e raportimeve të dhunës në familje ka rritje për vitin 2016 krahasuar me 2012-ën, konkretisht rreth 46,5% më shumë raportime. Shprehur

në terma absolutë, rreth 1.174 denoncime të dhunës më shumë. Sipas të dhënave të paraqitura, nuk përfshihet në rritjen e numrit të raportimeve qarku i Dibërës dhe ai i Shkodrës, të cilat kanë tren në rënie. Mësohet

3.900

RAPORTIME

Të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë tregojnë se në vitin 2016, duke e krahasuar me 2015-ën kemi 7,3% raportime më shumë. Ndërkohë, në total në rang vendi në 2016-ën numërohen 3.900 raportime të dhunës në familje. Përqindja më e lartë e denoncimeve vihet re në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit, dhe më e ulëta në qarkun e Dibërës dhe të Kukësit.

5.946

TË BURGOSUR

Në vitin 2016, në total kemi 5.946 të burgosur, ndërsa në vitin 2012 numëroheshin 4.550, duke treguar në këtë rast një rritje prej 30,6% në numrin e të burgosurve. Qarku i Tiranës shënon numrin më të lartë të të burgosurve për të dyja vitet në fjalë, 2012 dhe 2016, dhe qarku i Kukësit numrin absolut më të ulët të të burgosurve.

penale, jo për gjykim të cilat janë në kompetencë të organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin. Sipas të dhënave vihet re se në vitin 2016 Shqipëria ka një normë prej 108.6 personash të dyshuar për kryerjen e një vepr penale për 10 mijë banorë. Qarqet me numrin më të lartë të tyre janë Lezha, Tirana dhe Vlora, respektivisht me 137,7 autorë, 137,3 dhe 122,9 autorë për 10 mijë banorë. Ndërkohë, qarqet me normën më të ulët janë Dibra, Elbasani dhe Fieri. Për sa u përket statistikave të pasqyruara për të burgosurit, përfshihen personat e mitur, të rritur dhe shtetasit e huaj të cilët ndodhen në qendrat e burgimit; të paraburgosurit dhe të dënuarit me vendim të formës së prerë në Shqipëri. Vihet re se për vitin 2016 në total kemi 5.946 të burgosur, ndërsa në vitin 2012 numëroheshin 4.550, duke treguar në këtë rast një rritje prej 30,6% në numrin e të burgosurve. Qarku i Tiranës shënon numrin më të lartë të të burgosurve për të dyja vitet në fjalë, 2012 dhe 2016, dhe qarku i Kukësit numrin absolut më të ulët të të burgosurve. Në Shqipëri, nga 5.946 persona të burgosur gjithsej, 45,8% të tyre e përbëjnë të paraburgosurit, pra personat ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi "arrest në burg", dhe 54,2% e zënë të dënuarit me burg.

se më së shumti personat e dhunuar janë të miturit dhe femrat. Në Shqipëri, në vitin 2016 të miturit zënë 3,6% në totalin e gjithë personave të dhunuar, ose, shprehur në terma absolutë, numërohen 133 të mitur të prekur nga ky fenomen. Përqindja më e lartë e tyre shënohet në qarkun e Kukësit, me 6,5% të mitur të dhunuar. Ndërkohë, qarqet me përqindjen më të ulët janë Durrësi dhe Elbasani, me 1,6% dhe 2,5% të mitur të dhunuar. Për sa i përket dhunës së ushtruar ndaj femrave, në rang vendi numërohen në terma absolutë 2.825 femra që raportojnë dhunën në familje në vitin 2016, të cilat përbëjnë rreth 76% të të gjithë personave të dhunuar. Përqindja më e lartë e femrave të dhunuara është përqendruar në qarkun e Tiranës, me 36,5% femra të dhunuara, ndjekur më pas nga qarku i Durrësit. Ndërkohë, qarku i Kukësit dhe ai i Dibërës shënojnë përqindjen më të ulët të raportimeve, me 1,4% dhe 1,6% femra të dhunuara.

AUTORËT E VEPRAVE PENALE DHE TË BURGOSURIT

INSTAT bën me dije se statistikën e siguruar mbi autorët e veprave penale përfshijnë persona të dyshuar në kryerjen e një vepr

Gjyqi, avokati: Provat u manipuluan gjatë kohës kur mjeti ishte nën ruajtje nga policia

Ekzekutimi i Çollakut, tre efektivët: Gjetëm gjak në makinën e Shtrazës

"Gjurmët i konstatoam te goma rezervë 19 ditë pas vrasjes"



RRËMBIJA E GAZMEND ÇOLLAKUT

Më datë 06.01.2016, në lajzen nr.1 në Durrës, 4 persona, 3 prej të cilëve me jekelë dhe mbishkrimin "Policia", kanë marrë me forcë duke e futur në mjetin e tyre tip "Audi A6" me ngjyrë të zezë shtetasin Gazmend Çollaku, 34 vjeç, banues në Durrës. Ai u gjet i pajetë në Murqinë të Krujës. Rrëmbyesit e kishin torturuar 40-vjeçarën dhe lidhur këmbë e duar. të Krujës.

Ina Allkanjari

Tre oficerë policie të Drejtorisë së Durrësit dëshmuar dje në gjyqin ndaj Denis Shtrazës, i dyshuar për rrëmbimin dhe vrasjen e Gazmend Çollaku. Dy oficerët e Krimeve të Rënda të Policisë së Durrësit, Reban Farruku e Alfred Hoxha, dhe një oficer i Policisë Gjyqësore, Lorenc Dervishi, treguan se si u konstatuan njollat e gjakut në makinën "Mercedes ML" me të cilën dyshohet të jetë rrëmbyer Çollaku. Reban Farruku, u shpreh para togave të zeza se njollat e gjakut u konstatuan tri javë pas bllokimit të automjetit. "Kam bërë kontrollin paraprak të mjetit, në momentin kur ndalua Denis Shtrazën e Ervin Dalipaj, dhe më vonë në komisariat me elektrik dore. Mjeti u mbyll dhe qëndroi në oborrin e policisë. 19 ditë më vonë u çua në pikë bllokimi. Atje u konstatua njolla e gjakut dhe mjeti u kthye për këqyrje", - u shpreh Farruku gjatë seancës gjyqësore. Ndërkohë, Lorenc Dervishi, oficeri i Policisë Gjyqësore, dëshmoi se te pika e bllokimit mbahet një procesverbal

DËSHMIA

"Kam bërë kontrollin paraprak të mjetit, në momentin kur ndalua Denis Shtrazën e Ervin Dalipaj, dhe më vonë në komisariat me elektrik dore. Mjeti u mbyll dhe qëndroi në oborrin e policisë. Disa ditë më vonë u çua në pikë bllokimi. Atje u konstatua njolla e gjakut dhe mjeti u kthye për këqyrje", - u shpreh Farruku në gjyq.



Denis Shtraza në gjykatë

mbi gjendjen e mjetit. Ai sqaroi më tej, se në momentin që do shikonin gomën rezervë, vunë re praninë e njollave të gjakut dhe njoftuan prokurorin, e se pas kësaj makina u kthye për rishikim në polici.

Mësohet se prokuroria

ende nuk ka dhënë një përgjigje mbi ekspertimin e gjurmëve të dyshuara si gjak dhe nëse i përkasin apo jo të ndjerit Gazmend Çollaku, provë e cila do të lidhte të pandehurin me krimin për rrëmbimin e më pas vrasjen e Çollakut. Ndërkohë, avoka

tët kundërshtuan dëshminë e oficerëve të policisë, duke ngritur dyshime të forta se provat janë manipuluar nga policia gjatë kohës që makina mbahej në ruajtje prej saj. Sipas avokatëve mbrojtës, njollat u konstatuan 3 javë më vonë. Edhe vetë

i pandehuri Denis Shtraza reagoi ndaj dëshmisë së oficerëve, pasi sipas tij policët e kontrolluan mjetin me elektrik më datë 6 janar dhe nuk gjetën njolla gjaku. Ndërkaq, sipas tre efektivëve të policisë, Reban Farruku, Alfred Hoxha dhe Lorenc

Dervishi, mbrëmjen e 6 janarit ata kanë proceduar penalisht Ervin Dalipaj për mbajtje të paautorizuar të titujve, pasi kur e kanë ndaluar ai i ka paraqitur një dokument policie dhe pse prej disa kohësh ishte në kërkim.

Grabisnin, planifikuan një sulm të armatosur në Gjermani

Shkatërrohet banda kriminale italo-gjermane, mes 18 personave të arrestuar dhe 2 shqiptarë

ITALI - Në kuadër të një operacioni të përbashkët mes autoriteteve italiane dhe gjermane janë arrestuar 18 persona, 9 prej të cilëve u është dhënë masa e sigurisë "arrest me burg", ndërsa për 8 të tjerë është vendosur masa e sigurisë "arrest shtëpie" dhe "detyrim paraqitjeje". Ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim. Mësohet se në mesin e të arrestuarave janë edhe dy shqiptarët Loren Huqi dhe Erand Sallaku, të dy 34 vjeç, të cilët janë lënë në burg. Sipas mediave italiane, ata kishin rol kyç në koordinimin e grupit kriminal. Operacioni i koduar "Last day" është zhvilluar në provincat e Salernos, Napolit, Foxhias, Veronës, dhe në landin e Rheinland-Pfalz në Gjermani. Burimet e mësipërme bënë me dije se grupi kriminal grabiste furgonët e trans-



portimit të sendeve me vlerë dhe të institucioneve të kredive. Po sipas mediave italiane, në planet e grupit kriminal bënte pjesë edhe një

sulm i armatosur në Gjermani, por i parandaluar nga policia gjermane pas sinjalizimit nga homologët italianë.

Dyshime për larje hesapesh mes bandash për drogë

Atentati, policia greke: Viktimë e ngjarjes, shqiptari Roland Shëmbitras

GREQI - Një ditë pas atentatit që dy persona ende të paidentifikuar i bënë një 39-vjeçari shqiptar në Greqi, mediat e huaja kanë zbardhur identitetin e viktimës si dhe dyshimet për ngjarjen e rëndë. Sipas tyre, nga atentati i ndodhur mëngjesin e së dielës në "Glyfada". Athinë mbeti i vrarë shtetasi Roland Shëmbitras. Prej vitesh, ai është rezident në Greqi, i martuar dhe me dy vajza të mitura. Shëmbitras i ekzekutua rreth orës 04:40 me orën lokale, në një atentat mafioz jashtë një bari në rrugën "Agelo Metaksa". Sipas mediave greke, autorët të maskuar (dyshohet se janë shqiptarë), kanë ardhur në këmbë para lokalit dhe kanë qëlluar mbi 39-vjeçarin shqiptar, e më pas janë larguar me një makinë që i priste disa metra më tutje. Tre plumbat e kanë kapur atë në krahë, duke i shkakuar vdekjen e menjëhershme. Më pas autorët kanë hapur zjarr ndaj shokut të Shëmbitrasit, i identifikuar si Gjergj Kapaj, i cili ka mbetur i plagosur. Po ashtu të plagosur kanë mbetur edhe dy klientë të tjerë në lokal. Mësohet se dy personat e tjerë që u lënduan si pasojë e të shtënavave, janë shtetas grekë. Sakaq, dy ditë

më parë, policia greke tha se dyshohet për larje hesapesh mes bandash për çështje drogë. Ndërkohë mësohet se Shëmbitras ka qenë më herët në burg në Greqi. Po ashtu, hetuesit e huaj janë duke vijuar hetimet për të zbuluar edhe ndonjë konflikt të mundshëm që 39-vjeçari shqiptar mund të ketë pasur me ndonjë person kohët e fundit. Hetimet janë përqendruar edhe në zbulimin e identitetit të autorëve të krimit, si dhe për të bërë të mundur arrestimin e tyre. Për këtë, policia greke ka sekuestruar pamjet filmike të disa kamerave të sigurisë të bareve përgjatë zonës ku u ekzekutua Roland Shëmbitras, ndërsa janë marrë në pyetje edhe personat që ndodheshin në bar nëse kanë mundur të shohin ndonjërin prej autorëve që qëlluan mbi 39-vjeçarin. Sakaq, pas krimit të ndodhur, mediat greke shkruan se, duke iu referuar policisë greke, dëshmitarët okularë kanë deklaruar se atentatorët janë shtetas shqiptarë dhe se sapa i janë afruar lokalit kanë hapur menjëherë zjarr drejt 39-vjeçarit. Policia greke ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale 3 gëzhoja dhe kamerat e sigurisë.



Viktima Roland Shëmbitras

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria përbarimore "Corrector" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme.
- Pasuria Njësi me Nr. 3/417- N8, Zona Kadastrale 2364, me sipërfaqe 97.2 m², ndodhur në Laç;
Cmimi i ankandit të tretë është EUR 40,320 (dyzetë mijë e treqind e njëzetë euro).
Ankandi zhvillohet dt. 27/10/2017, ora 16.00 në adresën, Rruga "Kavajes", Ndertesa 27, Hyrja 1, Kati i III -te, Tiranë.
Kontakt: cel. 0684000061, ose në adresën e email: armels.lole@ncnb.al



STUDIO PËRBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METOXHA

Dt 12.10.2017 ora 16:00!
Përfundon Ankandi I Dytë për pasuritë:
- Apartamentme sip.totalë 72 m², me adres në Rr. "1 Maji" Korçë,
Me çmim 18 144 Euro
- Apartament me sip totale 86.03 m², me adresë në Pogradec
Me çmim 3 060 000 Lekë
Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Btv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

SHPALLJE E ANKANDIT TË PARË

Përbaruesi Gjyqësor Rok Deda me adresë Rruga Sulejman Delvina Ndertesa 51, Hyrja 9, App. Nr. 1,prane Hotel "Diplomat" Tiranë, njofton shpalljen e ankandit të tretë për aksionet e shoqërisë "ENARVI" shpk vetëm 12.85% e aksioneve të vilat janë në pronësi të z. Enea Troka me çmim të shitjes në anaknd në vlerën 10.691.856 (djetë milion e gjashtëqindëntëdhjetë mijë e tetëqindëpesëdhjetëgjashtë) lekë Personat e interesuar për të marrë pjesë në ankand , duhet të paguajnë 10% të vlerës në llogarinë me nr. 0000 360 171 në emër të Rok G. Deda PF në banken Raiffeisen. Ankandi mbyllet me dt. 16.10.2017 në ora 16:00

Në krye të grupit kriminal Taulant Haxhiraj, ende në kërkim efektiv Renaldo Avduli

Xhensila Kodra

Prokuroria për Krime të Rënda ka përfunduar hetimet dhe ka dërguar për gjykim dosjen në ngarkim të 8 shtetasve, pjesë të një grupi të strukturuar kriminal, të cilët ushtronin aktivitetin e paligjshëm të kultivimit të lëndës narkotike kanabis sativa në fshatrat Vezhdanisht e Trebovë, në Vlorë. Në bazë të hetimeve të Prokurorisë për Krime të Rënda, në këtë zonë Policia e Shtetit zbuloi një sasi shumë të madhe lëndë narkotike, të shpërndarë në parcala si dhe në proces tharjeje. Në krye të grupit të strukturuar kriminal qëndronte shtetasi Taulant Haxhiraj, i cili bashkëpunonte ngushtë me punonjës të policisë Renaldo Avdulaj si dhe me disa persona të tjerë. Këta të fundit kishin për detyrë marrjen e masave konkrete për kultivimin, magazinimin, dhe më tej shpërndarjen e lëndës narkotike. "Gazeta Shqiptare" ka mundur të sigurojë një ndër përgjimet e kryera nga një telefonatë mes policit Renaldo Avduli dhe kreut të grupit kriminal, Taulant Haxhiraj. Gjatë bisedës së zhvilluar mes tyre, Avdulaj i kërkoi Haxhirajt se, nëse i shkon ndonjë person i panjohur nga Kruja, të mos e qasë as për kafe dhe as për më tutje. "Mos e qas thashë, se është nga tanët hajtë (punonjës policie)", dëgjohet t'i thotë Avduli Hax-

Polici, trafikantit: Po erdhi ndonjë nga Kruja, mos e qas, është nga tanët

Çohen në gjyq 8 persona, mbillnin drogë në Vlorë



Në kërkim efektiv Renaldo Avduli

hirajt. Kështu, në përfundim të hetimeve, Prokuroria për Krime të Rënda akuzon për kryerjen e veprave penale "Kultivim i lëndëve narkotike, në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal", "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Kryerje e veprave nga

organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", shtetasit Taulant Haxhiraj, Renaldo Avduli, Shkëlqim Koçiaj, Xhovalin Baço, Reshat Radhima dhe Marjuz Bajrami. Ndërsa, për kryerjen e veprës penale "Moskallëzim krimi", akuzohen shtetasit Klajdis Imeri dhe Anis

- TË PANDEHUR**
- Taulant Haxhiraj
 - Renaldo Avduli
 - Shkëlqim Koçiaj
 - Xhovalin Baço
 - Reshat Radhima
 - Marjuz Bajrami
 - Klajdis Imeri
 - Anis Pajo

PËRGJIMI

Më datë 07.08.2016, ora 10:30, në një telefonatë të zhvilluar mes numrit xxxxx686, që përdoret nga shtetasi nën hetim Renaldo Avduli, dhe numrit që përgjigjet xxxxx762, që përdoret nga ana e personit nën hetim Taulant Haxhiraj, kemi këtë përmbajtje:

762 - O vlla,
686 - O vlla ç'a po bën ti,
762 - Hiq, të keqen, ja ketej?
686 - Ngjo vllain se s'kam kohë të flas se jam në punë,
762 - Hë vlla,
686 - Po erdhi nonji nga Kruja atje mos e qas as për kafe as për tutje nonji i panjohur Krutan,
762 - Ku vlla?
686 - Fushkruja. Aty,
762 - Pse?
686 - Mos e qas thashë se është nga tanët hajtë (punonjës policie),
762 - Nja nga Kruja?
686 - Eee,
762 - Mirë,
686 - Hajtë,
762 - Hajtë çau,
686 - Hajtë.

Pajo. Në bazë të veprimeve procedurale për këtë hetim, janë arrestuar edhe 4 persona të tjerë, të dyshuar për veprën penale "Kultivim i lëndëve narkotike". Për këta

persona, çështja është veçuar dhe hetimi i tyre i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Vlorës.

HETIMET
Nga hetimet e kryera re-

zulton e provuar se, nga ana e policisë gjyqësore janë siguruar dhe mbledhur të dhëna për aktivitetin kriminal të disa grupeve personash, shtetas shqiptarë, të cilët në mënyrë të organizuar kultivonin bimë narkotike në disa zona të rrethit Vlorë. Nga të dhënat, ka rezultuar se një grup personash, gjatë muajve prill dhe maj, pasi kanë siguruar më parë sipërfaqe toke, në pyll, kullota, tokë, në pronësi shtet ose në pronësi dhe posedim të personave privatë, që ndodhet në territorin e zonës administrative Vlorë, kanë filluar kultivimin e sasive të mëdha të bimëve narkotike të llojit kanabis sativa. Në vijim të hetimeve, në datën 04.10.2016, forcat e Policisë kanë ndërhyrë, duke realizuar arrestimin e 11 personave, ndërkohe që nuk është bërë i mundur ende arrestimi i shtetasit Renaldo Avduli.

CALL FOR EXPRESSIONS OF INTEREST

As an international cooperation enterprise for sustainable development with worldwide operations, the federally owned Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH supports the German Government in achieving its development-policy objectives. It provides viable, forward looking solutions for political, economic, ecological and social development in a globalised world. GIZ promotes complex reforms and change processes. Its corporate objective is to improve people's living conditions on a sustainable basis.

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, is announcing as following:

Call for expressions of interest

The GIZ project in Kosovo "Sustainable Municipal Services (SMS 2.0)" invites qualified companies to submit expression of interest in providing framework consultancy services for capacity development in waste management.

The amended Waste Law (2012) is the legal base for municipal waste management activities in Kosovo. According to this Law, municipalities have the full mandate for provision of municipal waste management services within their territory and in order to meet fulfil this obligation and carry out reforms public administration and public company officials need to possess the required knowledge and skills. With this in mind, education and training of waste management actors in the country is one of the main focuses of the current programme. In cooperation with KIPA (Kosovo Institute for Public Administration) training sessions are planned during 2017 that will officially certify waste managers in the country. This entails the development of training modules for the waste officials, development of modules for the Training of Trainers, and oversight of the first training session together with the newly certified KIPA trainers.

The checklist below provides further information about the conditions and expectations of the GIZ/SMS project. Based on responses to this Request for Information, GIZ will pre-qualify companies that will receive an inquiry and will be formally invited to submit their offers with detailed specifications. Response to the RFI (Request for Information) does not necessarily imply that your company will receive the GIZ's "Request for Capacity Development in Waste Management".

Based on the outcome of offers, GIZ/SMS project will offer a framework contract to the selected company. Please note that all correspondence and dealing with the GIZ must be in English language.

REQUEST FOR INFORMATION

- 1) Proof of company's legal status (registration and/or certification documentation), company details (name, postal address bank information etc.), date of incorporation within their initial response.
- 2) Companies should submit references to whom they have provided similar products as required by the GIZ/SMS project. Companies should note that referees may be contacted by the GIZ/SMS project at any time.

Interested companies are invited to submit expression of interest in **English language**.

The deadline for submitting the application is 12.10.2017 through a closed envelope to GIZ offices in Pristina, Rr. Anton vetta Nr.1, 10000 Pristina/Kosovo labeled "Expression of Interest in providing framework consultancy services for capacity development in waste management - VN:83268832".

Only shortlisted companies will be notified for further application procedures!

Një tjetër shqiptar vjedh të moshuarin

Grabitën 36 banesa, vihen në pranga 5 shqiptarë

ITALI - Policia italiane ka arrestuar pesë shqiptarë, duke i akuzuar ata si të përfshirë për vjedhje të dhjetëra banesave. Sipas mediave italiane, vënja në pranga e shtetasve shqiptarë, identiteti i të cilëve nuk bëhet i ditur për shkak të hetimeve, u krye pas akuzave se ata qëndrojnë pas 36 vjedhjeve që kanë ndodhur në Asti, Torino dhe Cuneo. "La Repubblica" raportoi edhe se viktimat e vjedhjeve nga hajdutët janë parajamëruar me shprehjen "Fli dhe nuk do të ndodhë asgjë". Ndërkaq, mësohet se banda e shqiptarëve të arrestuar përdorte disa pajisje marangozësh për të hapur dritare që të hynin brenda. Ata zgjidhnin shpëtitë ku mund të vidhnin shumë gjëra me vlerë, duke filluar nga paratë, bizhuteritë dhe orët, madje kanë vjedhur edhe ekspres kafeje. Hetuesit e huaj kanë dyshime se kjo bandë grabitësish mund të ketë bashkëpunuar me persona të tjerë. Hetuesit janë duke punuar për të zbuluar rreth identiteteve të personave që mund të jenë të përfshirë në grupin e pesë shtetasve shqiptarë, që tashmë kanë përfunduar në pranga. Ndërkaq, dy ditë më parë, policia italiane arrestoi një shqiptar 29-vjeçar, pasi akuzohet për një seri vjedhjesh. Rasti i fundit i vjedhjes ishte banesa e një 96-vjeçari italian, të cilit shqiptari i kishte marrë një televizor, një sasi të hollash cash si dhe karburant nga një rezervuar traktorësh. "Libero" shkruan se shqiptari akuzohet për vjedhje të tre banesave si dhe një të mbetur në tentativë, ngjarje që kanë ndodhur gjatë verës.

U vidhnin celularët qytetarë, policia arreston 4 adoleshentë

TIRANË - Policia e Tiranës ka shkatërruar një grup kriminal që ishte kthyer në tmerrin e kalimtarëve dhe qytetarëve në kodrat e Liqenit Artificial, duke arrestuar 4 adoleshentë. Në kuadër të operacionit të koduar "Mesnata", specialistët e Komisarariatit të Policisë Nr.1 kanë arrestuar shtetasit: E.G., 15 vjeç; K.H., 17 vjeç; E.M., 16 vjeç; si dhe A.G., 18 vjeç, të gjithë banues në Tiranë. Sipas policisë, këta persona u arrestuan, pasi iu është arritur t'i dokumentohet me prova ligjore se janë autorë të 4 ngjarjeve të ndryshme. Konkretisht, më datë 8 tetor kanë vjedhur me dhunë, aparatrin telefonik të markës "iPhone 7"; po në atë ditë kanë vjedhur me dhunë, aparatrin telefonik të markës "Samsung S5"; më datë 10 shtator kanë vjedhur me dhunë, aparatet telefonike të markave "Samsung S7 EG" dhe "iPhone 5S"; më datë 14 qershor kanë vjedhur me dhunë, aparatrin telefonik të markës "Samsung Galaxy S6". Në kuadër të këtij operacioni është bërë e mundur gjithë gjatja dhe sekuestrimi në cilësinë e provës materiale një "iPhone 7"; një "Samsung S 5"; 1 "Samsung S7 EG"; 15 gr kanabis; një kreher pistolete pa fishkë dhe një kaçavidë me ngjyrë blu, që e përdornin për vjedhjet.

Pedagogu erdhi në Shqipëri ditën e zgjedhjeve. Kapen në Malajzi edhe 2 shqiptarë të tjerë të lidhur me ISIS

Pedagogu i arrestuar për terrorizëm, nëna: Është kurth

Afërdita Zaimi: Im bir iku më 30 shtator. Është i pafajshëm, ne jemi pa bukë

Fatmir Popja

ELBASAN

Arrestimi në Malajzi i Klodian Zaimit, i cili njihet dhe me emrin fetar Ibrahim dhe që dyshohet se rekrutonte të rinj për t'iu bashkuar organizatës terroriste ISIS, ka shokuar familjen e tij në Cërrik. Tejet e tronditur, nëna e 35-vjeçarit, Afërdita Zaimi dje tha mes lotësh se djali i saj është i pafajshëm dhe se "ky është një kurth ose nga Shqipëria, ose nga Malajzia". E moshuara, banuese në Cërrik, u shpreh se i biri është larguar nga Shqipëria që kur ishte 16 vjeç dhe se ai nuk është i tillë, pra të përfshihet në terrorizëm. Edhe Adriatik Zaimi mohoi prerazi që djali i tij të jetë përfshirë në organizata terroriste. Vetëm tri ditë më parë, policia malajziane njoftoi se kishte arrestuar 8 persona, pasi dyshohet se kanë lidhje me ISIS-in, dhe se mes të pranësorëve është edhe një shqiptar, me profesion pedagog në një universitet publik në Malajzi, i quajtur Klodian Zaimi. Ndërkaq, dje u bë me dije se është rritur numri i shqiptarëve të arrestuar në Malajzi. Bëhet fjalë për dy shqiptarë me inicialet J.Z., nga Tirana dhe A.G., nga Lushnjë. Sipas burimeve policore, 35-vjeçari Klodian Zaimi dyshohet se ka financuar, in-doktrinuar e dërguar në Siri 20 shqiptarë që kanë studiuar në Siri dhe Jordani. Një pjesë e këtyre studentëve dyshohet se janë përfshirë në radhët e ISIS-it.

FAMILJARËT

Një ditë pas publikimit të lajmit për arrestimin e pedagogut shqiptar në Malajzi, "Gazeta Shqiptare" kontaktoi me prindërit e tij në Cërrik. Afërdita dhe Adriatik Zaimi pohan se nuk është aspak e vërtetë ajo që thuhet për djalin e tyre. "Më hyni në derë për mirë, jo këshu, o gazetarë... O Zot, dolëm në gazetë, në histori", - tha mes ngashërimesh, nëna e 35-vjeçarit, ndërsa disa të afërm të rrinin pranë me alkool në hundë. Ndërkohë, ajo u shpreh se "jam e bindur se ky është kurth i ngritur ose nga Malajzia, ose nga Shqipëria. Për tim bir të gjithë kanë respekt, të gjithë. Klodiani nuk e bën kurrë diçka të tillë". Afërdita Zaimi këmbënguli se i biri është i pafajshëm, ndërsa tha se atë e kishin zili. "Djali im nuk është nga ata. Nuk e kam djalin të tillë, ai është me doktoraturë. Më besoni, me lekë të pensionit kam blerë tapetin, se më vdiq kunati. Djali sh-



Klodian Zaimi, i arrestuar në Malajzi



Afërdita Zaimi, duke folur për "GSH" dhe "News 24"



(në rreth) Klodian Zaimi në faljen e Bajramit të Madh në Cërrik

PEDAGOGU SHQIPTAR

Klodian Zaimi, i cili u arrestua nga autoritetet malajziane së bashku me shtatë persona të tjerë, është nga Cërrik (dhëndër i një përfaqësuesi të Myftinisë në Belsh). Ai ka mbaruar studimet për teologji në Jordani, ndërsa është pedagog në një universitet publik në Malajzi. 35-vjeçari shqiptar mban emrin fetar Ibrahim.

ARRESTIMI

Policia malajziane njoftoi dy ditë më parë, se 8 persona janë vënë në pranga, pasi dyshohet se kanë lidhje me celulën terroriste ISIS. Mes 8 të pranësorëve, është edhe një shqiptar, me profesion pedagog. 5 nga militantët, raporton "Russai Today", që kanë lidhje me grupin "Abu Sayyaf" (ASG), me bazë në Filipine, u ndaluan pas një aksioni të madh në tri shtete.

SHKURT

Kontrabandonin naftë, arrestohen 4 persona

DURRËS - Katër persona janë arrestuar dy ditë më parë nga Policia Kufitare e Durrësit, pasi akuzohen për vjedhje dhe kontrabandë me mallra që paguhet akcizë. Bëhet fjalë për shtetasit: Sadri Haklaj, 31 vjeç, banues në Tiranë; Françesko Gërdeci, 24 vjeç, banues në Shijak; Sadik Krasnaj, 33 vjeç, banues në Durrës; dhe Artur Zhugri, 20 vjeç, banues në Kavajë, të cilët u pranësor pas një pune hetimore të miror-guanizuar. Sipas bluve, të rinjtë u kapën në flagrancë në kalatën lindore, në ish-Kantierin Detar Durrës, sepse kishin vjedhur naftë në anijet e peshkimit, me qëllim shitjen e saj.

Tragjedia në Torovicë, ekspertët: Shkak, erozioni

LEZHË - Dy ditë pas tragjedisë së ndodhur në Lezhë, ku humbën jetën tragjikisht dy vëllezër dhe bashkëshortja e njërit prej tyre, ekspertët e Gjeologjisë kanë dalë në përfundimin se shkak i rënies së gurit 20 tonësh në Torovicë është mungesa e bimësisë dhe erozioni. "Ai nuk është guri i parë që lëviz, ka qenë ndër masivët më të mëdhenj mund të themi. Lëvizja e atij guri ka ndodhur për shkak natyror, kuptohet, nga erozioni, mungesa e bimësisë", thanë ata. Sipas ekspertëve, të dyja anët e rrugës janë të rrezikshme, pasi janë vënë re edhe dy masivë të tjerë gurësh

"Jemi kundër ekstremizmit të dhunshëm e prirjeve radikale"

Myftiu Agim Duka: Klodian Zaimi nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë lidhje me Myftininë e Elbasanit

Pas arrestimit të pedagogut shqiptar Klodian Zaimi në Malajzi, i dyshuar si militant i ISIS-it, ka reaguuar myftiu i Elbasanit, Agim Duka. Ai deklaroi se Zaimi nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë lidhje me Myftininë e Elbasanit. "Deklaroi me kompetencë se shtetasit Klodian Zaimi nuk ka pasur asnjëherë emërim dhe angazhim në Myftininë e Elbasanit dhe në asnjë nga xhamitë e garkut të Elbasanit. Myftinia e Elbasanit ka qenë dhe mbetet e fokusuar në ruajtjen e Islamit tradicional mbështetur në statutin dhe në rregulloren e brendshme të KMSH-së.



Myftiu i Elbasanit, Agim Duka

Prej dy vitesh, Myftinia e Elbasanit zhvillon fushatë sensibilizuese me mbështetjen e organeve ndërkombëtare për forcimin e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe prirjeve radikale", - u shpreh Duka.

Gjithashtu, myftiu pohoi dje se "në Myftininë e Elbasanit nuk ka strehë askush që nuk respekton parimet dhe rregulloren e KMSH-së. Ne dënojmë me ashpërsi çdo veprim që bie ndesh me këto parime. Evidenti i rasteve të tilla është cenim i imazhit, vlerave të Islamit. Myftinia e Elbasanit që para 5 vitesh ka denoncuar shfaqjen e elementeve me prirje radikale në zonën e Cërriku. Aty ka ekzistuar një grup me prirje të rrezikshme, ku falë ndërhyrjes së KMSH-së, shtetit dhe faktorit ndërkombëtar është bërë neutralizimi i tyre".

Trafikantët hedhin drogën nga gomonia në det dhe i shpëtojnë policisë

VLORË - Mbrëmjen e së dielës, pas një ndjekjeje të gjatë në det, që nisi nga Policia Kufitare e Vlorës, Delta Forcë, Policia Kufitare e Durrësit (të ndihmuar nga Roja Bregdetare, Guardia di Finanza), në Vlorë u sekuestrua një gomone me 2 motorë të fuqishëm nga 300 kuaj fuqi.

Ndjekja ka nisur në ujërat territoriale shqiptare, dhe falë bashkëpunimit me policinë italiane, mjeti u gjurmua nga Guardia di Finanza e Barit me një avion dhe një helikopter, si dhe helikopteri i FRONTEX. Skafistët, duke e pasur të pamundur të vijonin rrugën drejt Italisë,

janë kthyer sërish drejt Shqipërisë. Pasi kanë përfutur nga deti i trazuar, trafikantët kanë hedhur lëndën narkotike në det dhe me shpejtësi kanë dalë në breg, në një zonë të vështirë, dhe janë larguar. Policia vazhdon operacionin e kërkimit të lëndës narkotike të hedhur në det.

Veliaj: Ftoj bizneset e qytetarët të kontribuojnë

Nisin punimet për parkun e ri në rrugën "5 Maji", hapësira çlodhëse për banorët

Bashkia e Tiranës ka nisur dje, punimet për ndërtimin e një parku të ri natyror në rrugën "5 Maji", në kryeqytet, i cili do të ketë ambiente çlodhëse prej 11 mijë m2, për të gjitha grupmoshat. Kryebashkiaku, Erion Veliaj inspektoi nisjen e punës dhe u shpreh se aksioni për mbjelljen e pemëve të reja do të shtrihet si brenda qytetit, ashtu edhe në periferi të tij. "Sot kemi kaluar në një pjesë tjetër të qytetit, ku ka nevojë për gjelbërim. Tani është koha e përshatshme për të mbjellë, e ne po i shtrijmë aksionet

PROJEKTI

Sipas projektit për rikualifikimin e hapësirës, bashkia do të mbjellë qindra pemë të llojeve të ndryshme, si dhe do të vendosë stola, kosha, ndriçim dhe module të ndryshme për të moshuarit dhe fëmijët. Një pjesë e territorit që do të lirohet nga mbetjet, do të shërbejë për ndërtimin e një shkollë të re, të pajisur me terrene sportive, duke plotësuar të gjitha nevojat e komunitetit të Njësisë 8.

tona si brenda qytetit në zona urbane, ashtu edhe në periferi. Sapo kemi pastruar një territor i cili ka qenë një lloj landfilli informal për

gjithë zonën e rrugës "5 Maji", - tha Veliaj. Sipas projektit për rikualifikimin e hapësirës, bashkia do të mbjellë qindra pemë të llojeve

të ndryshme, si dhe do të vendosë stola, kosha, ndriçim dhe module të ndryshme për të moshuarit dhe fëmijët. Por, krahas shtimit të gjelbërimit dhe vendosjes së moduleve të ndryshme, një pjesë e territorit që do të lirohet nga mbetjet, do të shërbejë për ndërtimin e një shkollë të re, të pajisur me terrene sportive, duke plotësuar të gjitha nevojat e komunitetit të Njësisë 8. "Ka ardhur koha që edhe këtu të bëjmë një shkollë të re, një nga 16 shkollat e reja, si dhe



Kryebashkiaku, Erion Veliaj gjatë inspektimit për nisjen e punës për mbjelljen e pemëve

të kemi një park urban në zemër të qytetit, në këtë pjesë të konsideruar periferi, por që sot është banuar dhe vazhdon deri te Bregu i Lumit", - tha Veliaj. Ai deklaroi se operacioni i mbjelljes së pemëve të reja do të vijojë deri në mars, për t'i lënë ven-

din më pas aksionit masiv për Pyllin Orbital. Në këtë kuadër, kryebashkiaku ftoi bizneset dhe qytetarët që të kontribuojnë në shtimin e hapësirave të gjelbra në kryeqytet, të cilat do të përmirësojnë cilësinë e jetës së gjithë komunitetit.

Mamografët e lëvizshëm në të gjithë Shqipërinë, shumica e femrave nuk diagnostikohen në kohë

Kanceri i gjirit, 500 raste të reja çdo vit
Ministrja: Ekzaminim falas për 5000 gra e vajza në vend

Voltiza Duro

Në vendin tonë, diagnostikohen rreth 500 raste të reja në vit të prekura nga kanceri i gjirit, i cilësuar si kanceri më i shpeshtë mes grave dhe vajzave në Shqipëri. Përgjatë gjithë territorit, mamografët e lëvizshëm do të udhëtojnë në të gjithë vendin, sipas kalendarit të paracaktuar për të kryer vizitat falas për të gjitha femrat. Në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit Kundër Kancerit të Gjirit, gratë e punësuar në fasoneritë e zonës së ish-Kënetës në Durrës, kryen dje ekzaminimin falas të mamografisë. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e pranishme në këtë nismë, vuri theksin te rëndësia e kontrollit të gjirit për çdo vajzë dhe grua, pasi diagnostikimi i hershëm shpëton jetë. "Është e rëndësishme të kuptojmë se beteja me kancerin e gjirit është një betejë që mund të fitohet! Në këtë muaj ndërgjegjësimit, nuk do të reshtim së thëni e ngulituri fort në mendjen e çdo vajze, çdo gruaje, se kanceri i gjirit është një kërcënim real për secilin prej nesh. Në Shqipëri ka çdo vit 500 raste të reja, gra e vajza të prekura nga kanceri i gjirit. Për fat të keq, shumica e rasteve shkojnë te mjeku në stade të avancuara, çka e bën kancerin e gjirit një nga shkaktarët e parë të mortalitetit të gratë", - u shpreh ministrja. Gjithashtu ajo u shpreh se mamografët e lëvizshëm do të shkojnë aty



Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e pranishme në nismën e luftës kundër kancerit të gjirit

5

MIJË EKZAMINIME

"Jemi në Kënetë të Durrësit, por paralelisht, shërbimi i mamografisë së lëvizshme po ofrohet aktualisht në Fier. Më pas do të ofrojmë shërbimin në Vlorë, Gjirokastrë e Përmet, për ta përmbyllur muajin me Lezhën. Por dua të theksoj se mamografët e lëvizshëm nuk do të ndalen. Vijojmë gjatë gjithë vitit, në çdo cep të Shqipërisë, duke mundësuar falas rreth 5 mijë ekzaminime në vit", - tha Manastirliu.

15%

TË VDEKJEVE

Përpos diagnostikimit dhe terapisë, kanceri i gjirit është shkaktari më i shpeshtë i vdekjes te gratë e moshës 40-50 vjeçe, pasi 15% e vdekjeve shkaktohen prej tij. Bazuar në një analizë të standardizuar të vendeve të Mesdheut, probabiliteti për kapjen e hershme dhe trajtimin e kancerit të gjirit, sipas raportit të vdekshmërisë me incidencën është 35%.

500

RASTE

"Në Shqipëri ka çdo vit 500 raste të reja, gra e vajza të prekura nga kanceri i gjirit. Për fat të keq, shumica e rasteve shkojnë te mjeku në stade të avancuara, çka e bën kancerin e gjirit një nga shkaktarët e parë të mortalitetit të gratë", - tha ministrja e Shëndetësisë.

ku janë nevojat, duke u dhënë mundësinë grave dhe vajzave të diagnostikohen

në kohë. "Do ta bëjmë këtë përmes një kalendarit tashmë të përcaktuar, duke sh-

kuar me mamografët tanë të lëvizshëm në çdo fshat apo qytet, duke ndihmuar në diagnostikimin në kohë të kancerit të gjirit. Jemi në Kënetë të Durrësit, por

KALENDARI I MAMOGRAFËVE TË LËVIZSHËM GJATË MUAJIT TETOR

- Në Librazhd Nga data 25 shtator - 6 tetor
- Në Fier Nga data 9 tetor - 11 tetor
- Në Vlorë Nga data 13 tetor - 17 tetor
- Në Gjirokastrë Nga data 18 tetor - 21 tetor
- Në Përme Nga data 22 tetor - 25 tetor
- Në Lezhë Nga data 26 tetor - 31 tetor
- Në Kukës Nga data 1 nëntor - 4 nëntor
- Në Dibër Nga data 7 nëntor - 11 nëntor

MAMOGRAFITË KRYHEN NË:

- Spitalin Rajonal Shkodër
- Poliklinikën Shkodër
- Spitalin Rajonal Elbasan
- Poliklinikën Korçë
- Poliklinikën Qendrore Tiranë
- S.U.O.GJ. "Mbretëresha Geraldinë"

paralelisht, shërbimi i mamografisë së lëvizshme po ofrohet aktualisht në Fier. Më pas do të ofrojmë shërbimin në Vlorë, Gjirokastrë e Përmet, për ta përmbyllur muajin me Lezhën. Por dua të theksoj se mamografët e lëvizshëm nuk do të ndalen. Vijojmë gjatë gjithë vitit, në çdo cep të Shqipërisë, duke mundësuar falas rreth 5 mijë ekzaminime në vit", - tha Manastirliu. Më tej, ministrja bëri me dije se po përmirësohet edhe flota e aparaturave për diagnostikimin e kancerit të gjirit, duket shtuar 5 mamografë të rinj për spitalin Onkologjik. "Gjej rastin t'u bëj thirrje të gjitha grave dhe vajzave, të gjejnë gjysmë ore kohë për të kry-

er këtë ekzaminim në spitalet dhe poliklinikat tona, përgjatë gjithë muajit, si paradite ashtu edhe në oraret e pasdites", - ishte thirrja e Manastirliut për të gjitha gratë e vajzat në vend. Kanceri i gjirit është një ndër karcinomat me të shpeshta të gratë dhe është shkaktari i dytë i vdekjes nga kanceri, pas kancerit të mushkërive. Bazuar në një analizë të standardizuar të vendeve të Mesdheut, probabiliteti për kapjen e hershme dhe trajtimin e kancerit të gjirit, sipas raportit të vdekshmërisë me incidencën është 35%. Përpos diagnostikimit dhe terapisë, kanceri i gjirit është shkaktari më i shpeshtë i vdekjes te gratë e moshës 40-50 vjeçe, pasi 15% e vdekjeve shkaktohen prej tij.

70-VJETORI I EKZEKUTIMIT

LETRA NGA POPULLI

"Të varen deputetët, të rrojë shoku Enver"

Fatmira Nikolli

Para së gjithash jetë të gjatë Shokut Enver dhe Partisë Komuniste. Telegramet të shkurtra, letra të gjata, pas një analize (!) të detajuar të "krimit" që kishte bërë grupi i deputetëve sabotatorë para 1947-ës, kërkojnë njëzëri, me të njëjtën gjuhë e me të njëjtë terma, dënimin maksimal për tradhtarët e kombit. Në copa telegramesh që kanë ende kokën "Mbretinija Shqiptare", grupime lagjesh, qytetesh, vullnetarësh, profesioneesh e zanatësh, drejtorish e studentësh, madje edhe nxënësit, thonë të kenë analizuar me detaje gjyqin popullor dhe kanë dhënë pas këtij qëmtimi një verdikt popullor nga të katërta anët e vendit, me një bindje të frikshme, hidhen vula e firma, madje ndokush që më gjasë nuk ka ditur të shkruajë, nuk ka ngurruar të pohojë mbështetjen për verdiktin duke firmosur me gjurmë gishtash. Kërkohet dënim i pamëshirshëm dhe kërkohet që shpata e drejtësisë të vërë dënimin kapital.

DEPUTETËT PËR DEPUTETËT

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të RPSSH, në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë, Institutin e Studimeve të Krimeve të Komunizmit dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike, me rastin e përkujtimit të 70-vjetorit të ekzekutimit të "grupit të deputetëve" organizon aktivitetin "Deputetët për Deputetët", që do të zhvillohet në sallën e seancave plenare, pranë Kuvendit të Shqipërisë, më datë 10 tetor, ora 11, në sallën e seancës plenare. Nga 21 të dënuar, 15 qenë deputetë të cilët u kundërvunë herët kufizimit të lirisë politike të shqiptarëve, duke u akuzuar si pro-perëndimorë. Kjo ngjarje shënoi edhe shkëputjen e Shqipërisë nga Perëndimi dhe vlerat e tij demokratike, që pasoi për pothuajse 5 dekada. Në bashkëpunim me 3 grupet parlamentare, 15 deputetë dhe përfaqësues të trupit diplomatik do reflektojnë me diskutime në një seance të posaçme mbi ngjarjen, sistemin totalitar, mendimin ndryshe dhe vlerat europiane, duke u bërë zëri i atyre deputetëve, të cilëve iu ndërpre jeta në mes. Do të mbajnë fjalë të rastit dhe kryeministri Rama dhe kryetari i opozitës, Basha si dhe ambasadorët e OKB-së, OSBE-së dhe Gjermanisë. AID-SSH do të zbardhë edhe materialet arkivore që gjenden për këtë gjyq, përmes një CD-je me materialet e dixhitalizuara.

LETRA NGA POPULLI

Mes autorëve të letrave nga populli që qenë "vigjilentë" përmendim të burgosurit e Kampit së Maliqit, 13 500 vullnetarët e hekurudhës së Rinisë Durrës-Elbasan, Ushtria Kombëtare Shqiptare, punëtorët civilë e ushtarakë të Shtypshkronjës Ushtarake, ushtarakët e reparatit 572, punëtorët e zdrukthëtarisë "Mistë Mame" dhe kantierit të NSHN-

Gjyqi i deputetëve më 1947, mbi 400 letra kërkonin "pa mëshirë, shpatën e drejtësisë"


Përkujtohen sot në parlament, në aktivitetin "Deputetët për deputetët" nga Autoriteti i Dosjeve



Në foto: Dokumente të Autoritetit



Në foto: Posteri i aktivitetit



13 500 TË BASHKUAR

Mjaft interesante mbetet sot të shohësh një letër që përfaqëson 13500 njerëz. Një perëndi e di, se si janë bashkuar tërë këta njëmendje për të kërkuar drejtësi, se si janë bashkuar të hartojnë e dërgojnë një letër, që për çudi duket si rripodhim i shumë të tjerave, sa duket ose sikur të tëra kanë një dorë që i bashkon, ose se ideologjia që përhapur ka shumë, sa të gjithë mendonin njësoj, njëherësh, një zë, si kor, trup i vetëm, gjykim i vetëm, të gjithë në një. "Telegram Durrës 19.9.1947 Gjykatës së Naltë Ushtarake Tiranë Ne, 13500 vullnetarët e Heku-



rudhës së parë të Rinos, duke ndjekur me vëmendje zhvillimin e procesit të gjyqit kundra tradhtarëve, spiunëve dhe armiqve të popullit, shprehim urrejtjen më të madhe për veprat e tyre kriminale dhe të poshtra. Ne që sulmojmë natë dhe ditë me kazma e lopata në shkëmbinj dhe objekte e që nuk kursejmë as pikën më të fundit të djersës për të ndërtuar jetën e re nën udhëheqjen e Enverit dhe të Partisë, nuk duromë që të cenohet pushteti ynë demokratik dhe veprat tona të lavdishme, që po ngrehim sot. Të revoltuar pra në kulm për krimet e tyre në kurriz të popullit kërkojmë nga trupi gjyqësor që shpata e drejtësisë të bjerë e pamëshirshme mbi këta spiunë sabotatorë, mbeturina të Ballit dhe Legalitetit të shtunë në sterlinat e anglo-amerikanëve. 13500 vullnetarët e Hekurdhës së Rinisë Durrës-Elbasan".

Ndërkaq, nuk harrohej të vihej në dukje se "agjentët dhe spiunazhet e imperializmit, sabotatorët dhe armiqët e popullit shqiptar nuk kanë pasur kurrë ndonjë herë dhe nuk do të kenë vend në Shqipëri e ENVERIT TONË të dashun t'Udhëheqësit të çuar të popullit shqiptar. Na ushtarakët e lartpërmendun i premtojnë komandantit t'onë të Përgjithshëm dhe Partisë t'onë heroike PARTISË KOMUNISTE" se kemi qenë dhe do të jemi gjithmonë vigjilentë dhe mbrojtës të fortë t'interesave të popullit tonë trim".

Kërkohet pra që, "shpata e drejtësisë (i njëjti term), të bjerë edhe mbi Riza Alizotin, përmes një letrë të punëtorëve të kantierit të Urës Vajgurore e Kuçovës".



Në foto: Gjyqi i deputetëve

Kush ishin të dënuarit, elita kulturore e firmëtarë të pavarësisë

Kastriot Dervishi: Pati tortura e manipulim të hetimit me kërcënime

Autoriteti i Dosjeve: 31 të gjykuarit dhe dënimet që iu dhanë nga gjyqi

Në vitin 1947, qeveria komuniste shqiptare ndërmoi një ndër raprezal jet e saj më të mëdha, një terror shtetëror, "sepse një pushtet i marrë me dhunë, nuk mund të mbahej ndryshe, veçse me akte dhune", por që përpara opinionit duhej të përligje çdo ndëshkim që kryente ka shkruar Tomor Aliko.

Nënkra, Kastriot Dervishi, ish-drejtuës i Arkivit të Ministrisë së Brendshme, flet për prova mbi manipulimin e procesit hetimor-gjyqësor në lidhje me "grupin e deputetëve". Sipas tij, provat tregojnë pavlefshmërinë e akteve që gjenden në dosjen hetimore-gjyqësore të gjyqit të shtatorit 1947. "Pjesa më e madhe e procesit hetimor dhe atij gjyqësor ndaj grupit të parë të deputetëve është e manipuluar nga hetuesia. Në rreshtimin e të gjitha provave të sigurara, rezultojnë se nën kërcënime për jetën e familjarëve dhe torturave të pashembullta është mundur të përpilohet një proces dokumentar, që nuk rezultoi në vërtetë. Mjafat këtu të përmend faktin se gjatë procesit gjyqësor kundër 24 të pandehurve, hetuesia ka mundur të vendosë të dhëna të paqena ndaj 20 personave, të cilët i ka vendosur edhe kundër njëri-tjetrit. Pra, vetëm me deklaratimet e 4 personave, defekte të tjera të hetimit si dhe me integrimin me proceset e tjera arrihet tek e vërteta. Si ilustrim i kësaj teze, sjell një provë tjetër në lidhje me një të dënuar dhe torturat e përdorura ndaj tij", bën me dije Dervishi. Ai shton se procesi ndaj grupit të deputetëve dhe intelektualëve të tjerë është zhvilluar nëpërmjet një procesi të tmerrshëm torturash. Sipas Dervishit, vija e falsitetit dhe e ekzagjerimeve në proceset e Sigurimit kaloi poshtë në qarqe dhe u deformua në një shkallë të atillë, sa që si për shembull në Gjirokastër, i pandehuri Agathokli Xhitoni, i cili në Tiranë me gjithë torturat për 3 muaj rresht nuk kallëzoi asgjë, arriti që atje që bëjë për veten e tij një proces komplet dhe të ngarkohet nga organet e Sigurimit që t'u përgatisë komplet proceset të arrestuarve të tjerë, duke i premtuar këtij lirim nga burgu.

EMRAT DHE JETËSHKRIMI

SHEFQET BEJA - 35 vjeç, tregtar, demokrat e patriot. Lindur në Durrës e banues në Tiranë. Pjesëmarrës aktiv në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, ekonomist e financier i aftë, politikan i zoti. Kontribuoi tepër në nxjerrjen e gazetës "Bashkimi", që mbeti organi kryesor i Frontit Nacionalçlirimtar, nënpresident i këtij fronti. Deputet i legjislaturës së parë. Dënohet me varje.

SULO ISMAIL KLOSI - 36 vjeç, i ati, Ismail Klossi, hapi shkollën e parë shqipe në Mallakastër. Njëri nga të katër udhëheqësit e rezistencës kundër Haxhi Qamilit. Kapet tradhtisht në Berat e pushkatohet nga ky i fundit në moshën 27-vjeçare. (Dëshmorët e Beratit 1915). I biri, Suloja merr pjesë në Lëvizjen Antizogiste të Fierit (1935), kapet dhe dënohet me vdekje, dënim që muaj më vonë i kthehet në burgim të përjetshëm,

pastaj lirohet me kusht që të kthehet në Francë, ku vazhdonte studimet. Diplomohet në Fakultetin e Gjeologjisë së Naftës në Strasburg dhe kthehet të punojë në zonat veriore të Shqipërisë. Gjatë luftës është i lidhur me forcat nacionaliste. Viti 1947 e gjen kryeinxhinier në Rubik. Dënohet me varje.

RIZA ALIZOTI - 37 vjeç, kryen filloren në Robert, Kolegjin e Stambollit. Vazhdon Teknikën e Fultcit në Tiranë, një vit kurs të lartë në Robert-Kolegj dhe studimet e larta në Oksford. Specializohet për shfrytëzimin e minierave në Strasburg, zotëron gjuhët anglisht, frëngjisht, turqisht. Punoi gjithë kohën në Kuçovë, para dhe mbas Çlirimit, për të vënë në shfrytëzim Kuçovën e rëndur nga lufta. Dënohet me varje.

SHEH IBRAHIM KARBUNARA - 67 vjeç. Një ndër ata patriotë, që me Ismail Qemalin firmosën Shpalljen e Pavarësisë (1912). Organizator dhe delegat i Kongresit të Lushnjës, anëtar i opozitës popullore dhe mik i Nolit, Gurakuqit e Currit. Si antizogist arratiset më 1924, emigrant politik në Bari.

Kthehet në teqenë e tij në Lushnjë (1939) e si nacionalist ndihmon në bashkimin e forcave politike për të çliruar Shqipërinë. Deputet i legjislaturës së parë. Dënohet me pushkatim me gjithë të birin.

DR. ENVER SAZANI - 37 vjeç. Mbaron shkëlqyeshëm gjimnazin e Korçës. Kryen studimet e larta për mjekësi, dy vjet në Monpelie, pjesën tjetër në Lion. Specializohet dy vjet të tjera për patologji-radiologji. Anëtar i degës së Çlirimit Nacional të Shqiptarëve të Francës (Lion -1933). Partizan i Çetës Krujë - Ishëm dhe i Çetës së Pezës. Drejtor i Spitalit Ushtarak. Deputet i legjislaturës së parë. Dënohet me pushkatim.

SALIM KOKALARI - 50 vjeç. Tre kushërinj (Muntaz, Vesimi e Syrja Kokalari) të pushkatuar me 1944 pa gjyq (lufta e Tiranës), kushërira Musine Kokalari e dënuar me 20 vjet burgim, një vit para arrestimit të tij. Dy vëllezërit i vdesin, njëri në burg (Izfiu) tjetri në internim (Isai). Salimi vetë kryen filloren në Gjirokastër. Në vitin 1916 emigron në Amerikë. Në vitet 1920-1924 është pedagog në Liceun Francez të Gjirokastrës. Kryen

dy vjet studime në Francë për pedagogji. Merr pjesë aktive në Lëvizjen e Vlorës (1932) dhe të Fierit (1935). Pas dështimit të kryengritjes, dënohet me varje në litar. I falet jeta dhe bën disa kohë burg. Gjatë pushtimit italian mbështet Luftën Nacionalçlirimtare. Është anëtar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar; dënohet me vdekje.

SELAUDIN TOTO - 33 vjeç. Vëlla i Ethem dhe Ismet Totos, të vrarë nga Zogu si kundërshtarë të tij. Kryen Shkollën Teknikë të Fulcit shkëlqyeshëm. Kryen studimet e larta për matematikë-fizikë në Torino. Për aftësitë e veçanta ftohet nga profesori i tij, atomisti i famshëm Enrico Fermi si bashkëpunëtor; çka për motive familjare e refuzon. Kthehet në atdhe me diplomën "excellente". Interonohet në 1941 si nacionalist kundër pushtesit fashist, në Itali. Themeloi Institutin e Shkencave Shqiptare dhe që kryetarit i parë i këtij instituti. Shkroi i pari artikujt mbi energjinë atomike në Shqipëri. Përktheu me elegancë "Njëzet vjet ngatërresa në Ballkan" të Miss Edith Durham. Deputet i legjislaturës së parë. Dënohet me pushkatim. Dhe do të vazhdonim kështu deri tek më i riu, 22-vjeçari Muhamet Prishtina, që ndoshta do të flijohet në atë moshë të njomë vetëm e vetëm pse ishte djali i patriotit Jahja Prishtina, njëri nga anëtarët themelues të Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës dhe nip i kryetarit të këtij komiteti, patriotit Rexhep Kadri Prishtina. Të mos harrojmë dhe të përemlemi para Paolo Sagiotti, 40 vjeç nga Gova e Italisë, që pasi kreu studimet në Institutin Industrial, vjen më 1931 për të punuar në AIPEN e për të gjetur "pushkatimin" në Kuçovë...

TË TJERËT

Irfan Majuni, 36 vjeç nga Dibra, banues në Tiranë, nëpunës, i martuar me fëmijë. Deputet i legjislaturës së parë. Dënuar me vdekje.

Tefik Deliallisi, 37 vjeç nga Shijaku, banues në Durrës, mësues, i martuar me fëmijë. Dënuar me vdekje. Hysen Shehu, 35 vjeç (djali i Sheh Karbunarës), i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Beqir Qela, 34 vjeç nga Durrësi, mësues, i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Abdul Kokoshi, 37 vjeç nga Vlora, me armë të lartë (fakultet drejtësie), banues në Tiranë, i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Pertef Karagozli, 39 vjeç nga Gjirokasta, banues në Tiranë, nëpunës, i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Agathokli Xhitomi, 59 vjeç, nga Përmeti banues në Përmet, shkruar publik, i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje. Me burgim të përjetshëm u dënuan: **Ramazan Tabaku** 46 vjeç, telegrafist nga Tirana; **Gjovani Vlashi** 24 vjeç, avokat nga Durrësi; **Foto Bala** 37 vjeç, profesor nga Himara (banues në Korçë); **Ram Marku** 46 vjeç, nga Shatëlli i Shijakut. Së fundi, me 20 vjet burgim: **Rustem Sharra** 40 vjeç, tregtar nga Kavaja; **Xhevat Xhafa** 34 vjeç, mësues nga Kavaja; **Shefki Minarolli**, 44 vjeç hotelier nga Pogradeci (banues në Elbasan) dhe 15 vjet **Sulo Konjari**, farmacist nga Gjirokasta. Por, në këtë inskenim kriminal u përshinë edhe shumë intelektualë të tjerë, që vdiqën gjatë torturave ose u vranë në hetuesi (**Kole Kullali**, **Syrja Selfo** etj.), që u dënuan ose u pushkatuan para dhe pas këtij gjyqi (**Koste Boshnjaku**, **Irfan Pustina**, **Suat Asllani**, **Sami Qeribashi**, **Riza Dani**, **Musine Kokalari**, **Gjergj Kokoshi** etj.



Agathokli Xhitomi, Rustem Sharra, Shefki Minarolli, Stefan Bumbçi, Sulo Konjari, Muhamet Prishtina

LISTA E TORTURAVE (SIPAS KASTRIOT DERVISHIT)

- 1 Jeleku (tortura më e tmerrshme, njeriu lidhet pas një huri dhe merr pamjen e një qengji që piqet në hell).
- 2 Kamxhiku dhe druri.
- 3 Të lënë të bukë, pa ujë, pa gjumë dhe në këmbë me ditë të tëra.
- 4 Korrenti elektrik deri sa i binte të fikët.
- 5 Hedhja në qafë e zinxhirëve me peshë të rëndë.
- 6 Lidhja me duar nga pas në dritare ose në ndonjë dru varur deri sa t'i priten gishtat.
- 7 Thyerja e kockave dhe ndukja e mishit me darë (kjo u përdor sidomos pas dënimit me vdekje të Shefqet Bejës dhe kundra tyre).
- 8 Kripa në gojë.
- 9 Shpifnin goja sikur do të ekektuoheshin ose do të vareshin dhe u shtihet në ajër ose shpifeshin të litari.
- 10 Tortura morale në lidhje me familjen: do të burgosim, do të t'i vrasim, bile në Shkodër për të thyer rezistencën e Dulo Kalit shpunë në një dhomë ngjitur me të dy të burgosura vajza dhe dy të burgosur burra dhe ato bënë goja sikur ishin vajzat e tij dhe i kishte prurë t'i çnderuar.
- 11 Futja kokëposhtë në vozë plot me ujë.
- 12 Një herë Myftar Tarja (hetues-shënim) i futi një Toptanit nevojë në gojë dhe çorape të palara.
- 13 Djegia e mishit me cigare. Në fund kundra një provokatori të Kukësit i është hedhur alkool në duar ose në leshra.
 - Gjellë me kripë e lënia pa ujë.
 - Futje në ujë dhe lënie me tesa të lagura në dimër.
 - Pakësim i ushqimit gradual për të vdekur brenda 1 ose 2 vjetëve.
 - Lënia pa gjumë në këmbë.

TURQI - SHBA-të dhe Turqia kanë pezulluar për një kohë të pacaktuar lëshimin e vizave ndaj qytetarëve respektivë, në kundërpërgjigje ndaj njëra-tjetrës. Përplasja vjen pas arrestimit të një punonjësi të zyrës konsullore amerikane në Ankara nga autoritetet turke. Punonjësi i ambasadës amerikane, me shtetësi turke, është arrestuar me akuzën e bashkëpunimit me rrjetin FETO të Fetullah Gylen. Zyra konsullore amerikane shprehu shqetësimin e thellë dhe deklaroi pezullimin e të gjitha vizave. Të njëjtin qëndrim mbajti dhe zyra konsullore turke në SHBA, duke ndërprerë punën për lëshimin e vizave ndaj qytetarëve amerikanë. Sipas "BBC", deklarata e autoriteteve turke ishte një



Krizë në marrëdhëniet Turqi-SHBA, pezullohen vizat

Arrestohet zyrtari i konsullatës amerikane në Stamboll për bashkëpunim me Fetullah Gylen

thënë Jashari. Situata në Luginën e Preshevës është tensionuar mjaft dhe rrezikon të shpërbëhet për shkak të debimeve masive të shqiptarëve nga ajo pjesë nga ana e Serbisë. I përndjekuri politik dhe ligjërues i marrëdhënieve ndërkombëtare, Fatmir Arifi, ka thënë para pak muajve se Serbia, përmes strategjisë së saj po shkatërron gjithçka shqiptare. Jonuz Musliu, kryetar i Këshillit Nacional Shqiptar për Luginën e Preshevës, ka bërë me dije se vazhdimisht po ushtrohet dhunë psikike nga ana e Serbisë në këtë pjesë, duke i detyruar të largohen mijëra shqiptarë, dhe se, nga 100 mijë që ishin atëherë, tani janë 60 mijë. Një reagim tjetër që e thellon më tej çështjen e përpjekjeve të Serbisë për të asimiluar shqiptarët ka qenë ai i kryetar-

thënë Jashari. Situata në Luginën e Preshevës është tensionuar mjaft dhe rrezikon të shpërbëhet për shkak të debimeve masive të shqiptarëve nga ajo pjesë nga ana e Serbisë. I përndjekuri politik dhe ligjërues i marrëdhënieve ndërkombëtare, Fatmir Arifi, ka thënë para pak muajve se Serbia, përmes strategjisë së saj po shkatërron gjithçka shqiptare. Jonuz Musliu, kryetar i Këshillit Nacional Shqiptar për Luginën e Preshevës, ka bërë me dije se vazhdimisht po ushtrohet dhunë psikike nga ana e Serbisë në këtë pjesë, duke i detyruar të largohen mijëra shqiptarë, dhe se, nga 100 mijë që ishin atëherë, tani janë 60 mijë. Një reagim tjetër që e thellon më tej çështjen e përpjekjeve të Serbisë për të asimiluar shqiptarët ka qenë ai i kryetar-

dyshtuar për grusht shteti. Sipas medias turke, kriza e fundit mes Turqisë dhe SHBA-ve është e paprecedentë në marrëdhëniet mes dy vendeve aleatë në NATO që prej viteve 1950. Sipas tyre, SHBA-të kanë ndër-marrë masa të ngjashme edhe ndaj Libisë, Jemenit apo Sirisë, por situata në ato vende është krejt tjetër si pasojë e luftërave që vazhdojnë prej vitesh. Kriza ka sjellë një zhvlerësim të monedhës vendase, lirës turke, përballë dollarit dhe euros.

dyshtuar për grusht shteti. Sipas medias turke, kriza e fundit mes Turqisë dhe SHBA-ve është e paprecedentë në marrëdhëniet mes dy vendeve aleatë në NATO që prej viteve 1950. Sipas tyre, SHBA-të kanë ndër-marrë masa të ngjashme edhe ndaj Libisë, Jemenit apo Sirisë, por situata në ato vende është krejt tjetër si pasojë e luftërave që vazhdojnë prej vitesh. Kriza ka sjellë një zhvlerësim të monedhës vendase, lirës turke, përballë dollarit dhe euros.

"Qytetarët në hall, vetëm në Gjilan janë mbi 2 mijë persona që kanë këtë problem"

Serbia çregjistron banorët e Luginës së Preshevës, Kosova nuk i regjistron

Avokati i Popullit, Jashari: Është shkelje e rëndë

Egla Xhemali

PRESEHËVË

Banorët e Luginës së Preshevës janë në një hall të madh. Serbia po i çregjistron në vendin e tyre të lindjes, ndërsa ata nuk po mund të regjistrohen në Kosovë. Këtë problem e ka ngritur në "KTV", Avokati i Popullit, Hilmi Jashari. "Shkelja e madhe që po ndodh është ajo me qytetarët e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës. Një numër i madh i këtyre qytetarëve që jetojnë në Kosovë për shkaqe të ndryshme, Serbia po i diskriminon tash e sa vjet vazhdimisht, duke i regjistruar nga listat e vendbanimit dhe duke i penguar në të drejtat civile, duke filluar nga nxjerrja e dokumenteve elementare siç janë certifikatat dhe dokumentet e tjera", - ka sqaruar Jashari.

ÇREGJISTRIMI

"Shkelja e madhe që po ndodh është ajo me qytetarët e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës. Një numër i madh i këtyre qytetarëve që jetojnë në Kosovë për shkaqe të ndryshme, Serbia po i diskriminon tash e sa vjet vazhdimisht, duke i regjistruar nga listat e vendbanimit dhe duke i penguar në të drejtat civile, duke filluar nga nxjerrja e dokumenteve elementare siç janë certifikatat dhe dokumentet e tjera", - ka sqaruar Jashari.

menteve elementare siç janë certifikatat dhe dokumentet e tjera", - ka sqaruar Jashari. "Gjithashtu, edhe nga autoritetet kosovare, këtyre qytetarëve nga Lugina e Preshevës u pamundësohet nxjerrja e dokumenteve të Kosovës. Pra këta qytetarë janë në gjendje shumë të keqe", - vijoi ai. Sipas tij, vetëm në rajonin e Gjilanit janë mbi 2 mijë persona që kanë këtë problem. Ai ka premtuar se do të bëjë çmos

që të argumentojë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për këtë shkelje të të drejtave të njeriut që po iu bëhet këtyre qytetarëve dhe, sipas tij, që Serbia të marrë gjykimin e merituar për fshirjen e këtyre banorëve shqiptarë nga regjistri. "I njëjti rast ka ndodhur edhe me Slloveninë, ku komuniteti boshnjak është fshirë nga regjistrat dhe Sllovenia e ka humbur këtë betejë në gjyq", - ka

që të argumentojë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për këtë shkelje të të drejtave të njeriut që po iu bëhet këtyre qytetarëve dhe, sipas tij, që Serbia të marrë gjykimin e merituar për fshirjen e këtyre banorëve shqiptarë nga regjistri. "I njëjti rast ka ndodhur edhe me Slloveninë, ku komuniteti boshnjak është fshirë nga regjistrat dhe Sllovenia e ka humbur këtë betejë në gjyq", - ka



it të Partisë Demokratike Shqiptare në Luginën e Preshevës, Ragmi Mustafasa. Në një intervistë për mediat, ai ka thënë se shqiptarët do të këmbëngulin për të drejtat dhe për t'u identifikuar me flamurin e tyre. "Kjo sjellje e Serbisë, pa dyshim është përpjekje e vazhdueshme për të asimiluar shqiptarët, por aq më shumë u jep forcë sh-

qiptarëve që të këmbëngulin në këto të drejta dhe të identifikohen me flamurin kombëtar - siç identifikohen shqiptarët në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e gjithandej. Prandaj, një përpjekje e vazhdueshme e Shqipërisë në këtë fushë duhet të jetë më e intensifikuar në një shkallë më të lartë", - ka thënë Mustafa.

FOTO LAJM

Deseret Tavares, një parashikuese fati nga Amerika, tronditi me deklaratën e saj. Ajo u shpreh për "Los Informantes" se Donald Trump nuk do t'i japë fund mandatit, pasi e pret një fat tragjik. Tavares tha se Trump në dy vitet e para të presidencës do të vritet nga një amerikan.

KOLUMBIA PARASHIKON VDEKJEN E TRUMP



Kriza në Mianmar

Përmbyset anija, 10 fëmijë të mbytur

Së paku 12 persona kanë ngelur të vdekur dhe dhjetëra të tjerë janë ende të zhdukur pas përmbysjes së një anijeje në lumen Naf. Në bordin e saj ishte një numër i madh myslimanësh, që përqeshin të largoheshin prej dhunës në Mianmar. Ngjarja ndodhi ditën e së dielës, shumë afër Bangladeshit. BBC-ja ka arritur të mesojë nga rojet kufitare të Bangladeshit se të paktën 12 persona kanë ngelur të vdekur e shumë të tjerë janë shpallur të humbur. Deri tani, rojet kufitare kanë arritur të gjejnë trupat e 10 fëmijëve të mbytur, të një gruaje dhe të një burri. Burime nga zyrtari i rojës bregdetare Abdyl Jalili, shprehen se mendohet që mund të kenë qenë deri në 100 persona në momentin e ngjarjes, midis tyre shumë fëmijë të cilët rezultojnë të humbur. Shumë myslimanë Rohingya kanë vdekur duke u përpjekur të largohen prej dhunës në Mianmar. Rreth 60 persona besohet se kanë vdekur në një incident të ngjashëm në shtator, ku Aung San Suu Kyi, si lider 'de facto' i Mianmar, kishte shansin e fundit që të ndalonte ofensivat ushtarake.

Roza	Gucia(Pavaci)	Roza	Gucia(Pavaci)	Sip. E papercaktuar		547	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka VFJ Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Lorenc	Shiroka	Lorenc	Shiroka	Sip. E papercaktuar		546	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Ndue	Guka	Ndue	Guka	Sip. E papercaktuar		545	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Nuk ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Luc	Lika	Gjon	Gjeloshi	Sip. E papercaktuar		544	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Shtjefen	Tuku	Shtjefen	Tuku	Sip. E papercaktuar		543	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Geg	Palushi	Geg	Palushi	Sip. E papercaktuar		542	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Zef	Zeka (Palaj)	Alfons	Palaj	5000m2	Palaj / 2859	541	5000	5000	Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Zef	Mani	Zef	Mani	Sip. E papercaktuar		540	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Pjeter	Cuni(Gilaj)	Ndue	Gilaj(Cuni)	Sip. E papercaktuar	Abat / 1000	539	400	400	Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Vitore	Nino	Zef	Staku	Sip. E papercaktuar		538	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Gjush	Gjergji	Vincens	Gjergji	Sip. E papercaktuar		537	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Zef	Mjeda	Zef	Mjeda	Sip. E papercaktuar		536	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Jonuz	Meta	Skender	Meta	Sip. E papercaktuar		535	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Lazer	Alija	Lazer	Alija	Sip. E papercaktuar		534	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Berhan	Zaganjori	Berhan	Zaganjori	Sip. E papercaktuar		533	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Shuajp	Xhemja	Shuajp	Xhemja	Sip. E papercaktuar		532	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Syri	Rroji	Syri	Rroji	sip. E papercaktuar		531	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Pal	Gjini	Pal	Gjini	Sip. E papercaktuar		530	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Mat	Doda	Mat	Doda	250m2 truall	Gomsiqe / 1799	529	250	250	Ka vert.pron esie Ka Harte Me vendimin nr. 378, dt. 3.8.2011 te AKKP, qe l perket dosjes nr. 383, dt. 15.10.2010 sip. 250 m² l eshte kthyer subjektit. Nuk rezulton te jete pletesuar rubrika e titullit ekzekutiv te ketij vendimi.
Rrok	Povaci	Rrok	Povaci	450m2 truall	Shiroke / 8591	528	450		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Sulejman ; Gani	Bushati	Sulejman ; Gani	Bushati	kthimin e mullirit	Bushat / 1329	527			Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Familja Mema		Zyhdi	Mema			526	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Pjeter	Pali	Violeta	Muzhani			525	vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua

(Vijon nesër)

Dje në "Der Standard"

Vetingu, Rama: Një pjesë e konsiderueshme e njerëzve të drejtësisë do të pushohen

Nga Adelheid Wolf

(Vijon nga faqja e parë)

... "Kjo nuk dihet kurrë me BE-në, sepse tek ajo ndryshojnë vazhdimisht pozicionet dhe kushtet. Ne i kemi kryer të gjitha dhe do të shohim. Mund të bëhet vitin e ardhshëm, në qoftë se Këshilli i BE-së shpreh një mendim pozitiv për këtë, por edhe mund të ndodhë që të mos bëhet vitin e ardhshëm. Nuk është fjala për Shqipërinë", tha Rama. I pyetur nga gazetaria austriake Adelheid Wolf se a ka hequr për ngjarjen e vitit 1991 në Shkodër, ku është implikuar emri i kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi, Rama tha: "Kjo ishte hetuar tashmë në një çështje gjyqësore dhe ai u lirua nga të gjitha akuzat e cmen-dura".

Në Shqipëri, këto ditë, komisionet e verifikimit fillojnë të gjejnë ata gjykatës dhe prokurorë, që janë të korruptuar, ose që kanë shpërdoruar detyrën e tyre. Çfarë prisni ju nga ky proces?

Këto verifikime janë vendimtare për një arkitekturë të re të sistemit, të cilin e kemi ndryshuar me anë të reformave të thella. Ne kemi një pallat të ri drejtësie. Dhe këto verifikime do të sigurojnë që banorët e këtij pallati të skanojnë, disa nuk do të mund të futen brenda. Do të varet edhe nga akuzat, që do të bëjnë (paraqesin) një formë të re drejtësie. Së shpejti do të shohim rezultate konkrete.

Por edhe rezistencë kundërshtuese?

Rezistenca kundërshtuese ishte e pranishme që në ditën e parë. Por tani procesi e ka kaluar pikën kritike dhe reformat nuk u ndryshën.

Sa thellë ka zënë vend korruptsioni në sistemin e drejtësisë shqiptare?

Një pjesë e konsiderueshme e njerëzve me siguri do të pushohen. Procesi i tanishëm nuk lejon hapësirë për ta, që ata t'i shpëtojnë, apo të depërtojnë në sistemin.

Reforma e drejtësisë është e lidhur edhe me fillimin e tratativave për anëtarësim me BE-në. Kur do të mund të fillojnë ato?

Kjo nuk dihet kurrë me BE-në, sepse tek ajo ndryshojnë vazhdimisht pozicionet dhe kushtet. Ne na u tha që tratativat fillojnë kur të bëhet reforma kushtetuese në kapitullin e drejtësisë. Kështu, ne e ndryshuam Kushtetutën, por bisedimet për anëtarësim nuk filluan. Pastaj na u tha, që për të filluar tratativat është i rëndësishëm ligji për komisionet e verifikimit. Pastaj na u tha që janë të rëndësishme zgjedhjet, që të mund të fillojmë. Tani, ne i kemi kryer të gjitha dhe do të shohim. Mund të bëhet vitin e ardhshëm, në qoftë se Këshilli i BE shpreh një mendim pozitiv për këtë, por edhe mund të jetë, që të mos bëhet vitin e ardhshëm. Nuk është fjala për Shqipërinë. Procesi i zgjerimit është bërë gjithnjë e më shumë jo-fair dhe për shtetet më pak i parash-

Albaniens Premier Rama: "Unfair, dass wir nicht mit der EU verhandeln"

INTERVIEW
ADELHEID WÖLFL
7. Oktober 2017, 12:00



Edi Rama kritisiert die EU-Erweiterungspolitik und plädiert für ein Europa verschiedener Geschwindigkeiten

Richter und Staatsanwälte in Albanien sind derzeit mehr als nervös. Im Zuge der Justizreform sollen nun durch Fachkommissionen jene Personen herausgefiltert werden, die ihr Amt missbrauchten und sich bereicherten. Bis jetzt konnte man praktisch jedes Urteil kaufen, Richter und Staatsanwälte handelten auf Zuruf, viele Kriminelle und ihre Freunde waren unantastbar. Nun wird jeder – angefangen von ganz oben mit der Generalstaatsanwaltschaft – durchleuchtet. Albanien Premier Edi Rama spricht im STANDARD-Interview von "entscheidenden Überprüfungen", von denen man "schon bald konkrete Ergebnisse" sehen werde. Rama findet es zudem "unfair", dass sein Land noch nicht mit der EU verhandelt, und spricht sich für ein Europa

foto: Reuters

"Es ist absurd zu sagen: Ihr seid ein Kandidat für den Beitritt, aber wir verhandeln nicht mit euch. Das ist so wie wenn man sagt: Wir wollen heiraten, aber wir sprechen nicht über die Hochzeit". sagt



Kryeministri për "Der Standard": Kanabisi është zhdukur nga toka e Shqipërisë

ikueshëm. Kjo ka të bëjë me vetë Europën.

A prisni ju një ndryshim kurs në strategjinë e zgjerimit?

Këtë nuk e pres. Dhe problemi nuk është se çfarë thotë Europa, por çfarë bën ajo. Ata kanë thënë që nuk bëjnë zgjerim, por çështja në të vërtetë është se sa zgjerim bëjnë. Në rastin tonë është tërësisht jo-fair; sepse ne jemi një shtet i NATO-s, Mali i Zi ka aderuar në NATO shumë më vonë. Përveç kësaj, te kapitujt vendimtarë të drejtësisë, ne jemi shumë më përpara se Mali i Zi. Edhe Serbia duhet t'i bëjë akoma këto reforma. Ne këtë e kemi bërë tashmë. Është fantastike që ata janë në tratativa! Është thjesht jo-fair që ne nuk jemi në tratativa! Unë nuk e kuptoj edhe këtë frikë të pabesueshme të udhëheqësve europianë, kur ata vazhdimisht lidhin fillimin e tratativave për anëtarësim me zgjedhjet (në ven-



"Procesi i zgjerimit është bërë gjithnjë e më shumë jo-fair"

në atë, që në Serbi janë rritur frikërat nga një Shqipëri e Madhe, pra, nga një bashkim i Shqipërisë dhe Kosovës. I kuptoni ju këto frikëra?

Këto frikëra nuk rriten. Kjo do të ishte njësoj, sikur unë, për diçka që thotë Vuçiç (President i Serbisë, shënim i redaksisë), të thosha se ai flet për Serbinë e Madhe. Nuk është se unë e dëshiroj këtë, por është fjala për logjikë. Kosovarët ishin nën një regjim shumë brutal dhe ata nuk mund të udhëtonin për në Europë dhe tani, ata kanë një shtet të vetin dhe prapë nuk mund të udhëtojnë për në Europë. Nuk ka vetëm lodhje zgjerimi, ka edhe një lodhje durimi.

Kur ju përmendni "unione më të vogla", është e qartë që ju flisni për një union me Kosovën...

Ne nuk jemi më në komunikim dhe prandaj mund të flasim haptas. Gjyshërit e kosovarëve të rinj jeto-

nin në një shtet që nuk e njohte kombësinë e tyre dhe statusin e një republike. Tani, ata kanë në të vërtetë një shtet të vetin, por tani ata janë izoluar në një gjendje pezull. Ata janë popullsia e vetme në gjithë Europën që nuk mund të dalë jashtë vendit të saj. Dhe në fakt, për shkak të ndonjë budallallëku! Atyre u janë vënë kushte që të lirohen nga vizat për zonën e Shengenit. BE-ja ka thënë: Ju duhet që në fillim të bëni një marrëveshje kufitare me Malin e Zi, por njëkohësisht BE-ja bën tratativa me Serbinë, me një shtet që akoma nuk e ka njohur Kosovën, jo më kufijtë e Kosovës.

Çfarë dëshironit të ndryshonit në menaxhimin e kontrollit të kufijve me Kosovën?

Tani ka kontrole shumë të rënda dhe duam një menaxhim kufiri më të lehtë, por jo pa kontroll. Sidoqoftë, palët do të jenë së bashku.

Si menaxhimi i integritetit të kufirit midis Malit të Zi dhe Shqipërisë?

Edhe më të lehtë. Sipas një studimi të Bankës Botërore, njerëzit dhe mallrat presin 3.800 vjet në një vit në kufijtë në Ballkan.

A do të merrni të njëjtat masa për lehtësimin e kufirit me Malin e Zi dhe Greqinë?

Ne jemi të gatshëm ta bëjmë këtë me çdo kusht. Por në rastin e Kosovës duhet ta bëjmë këtë, sepse shumica e njerëzve kalojnë në këtë kufi.

D.m.th. është për trafikun e pasagjerëve?

Jo, është e lidhur me transportin e mallrave në të gjithë rajonin, çka është pjesë e një



Opinioni *i* Ditës

Nga Tritan Shehu

(Vijon nga faqja e parë)

... përkeqësimin serioz të standardeve të zgjedhjeve në Shqipëri. Ndërsa në vitin 2009 zgjedhjet u cilësuan se kishin arritur shumicën dërrmuese të standardeve ndërkombëtare, zgjedhjet e vitit 2017 kanë cenar rëndë një numër të standardeve baze.

Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë konstatuar shpërndarje masive të votës nëpërmjet përdorimit të parave kriminale që vijnë nga trafiqet e drogës dhe korrupsioni galopant. Shpesh, ky fenomen është përdorur për të supresuar pjesëmarrjen në votim të votuesve të opozitës, kundrejt marrjes me anë të pagesës të dokumentit të identitetit të nevojshëm për votim, duke penguar në thelb të drejtën për të votuar.

Vëzhguesit kanë konstatuar numër të lartë të presionit ndaj zgjedhësve për të marrë pjesë në fushatë dhe për të votuar në favor të partisë në pushtet, Partisë Socialiste, nëpërmjet kërcënimit me humbje të vendit të punës në administratën publike. Për herë të parë këto kërcënime janë konstatuar edhe në sektorin privat. Kjo cenon standardin e lirisë për të votuar pa frikë nga reperkusionet.

Shpërndarja e votës dhe presioni janë kryer në bashkëpunim me një rrjet të gjerë kriminal që kontrollon kultivimin dhe trafikun e kanabisit si dhe të drogave të tjera të forta.

Vëzhguesit kanë konstatuar abuzim masiv me ?burimet dhe asetet publike në favor të partisë në pushtet. Shërbime publike dhe lëshim titujsh pronësie janë përdorur gjerësisht për të ndikuar në votën e zgjedhësve. Kjo cenon parimin e ndarjes së shtetit nga partitë politike.

Po ashtu është konstatuar në shumë raste cenimi i sekretit të votës në qendrat e votimit, presion mbledhës të komisionerët brenda tyre, votim familjar, në grup apo proxy.

Qeveria nuk ka vullnet për zgjedhje të lira



Për të gjitha këto, vëzhguesit ndërkombëtarë kanë nxjerrë për herë të parë rekomandime prioritare. Që pas vitit 2013 kur erdhi në pushtet, PS-ja nuk ka lejuar të kryhet reformë zgjedhore. Si rrjedhojë, rekomandimet e 2013-ës dhe

2015-ës nuk janë trajtuar ende. Kjo përbën shkelje të angazhimeve të Shqipërisë para KIE dhe OSBE-së. Rekomandimi i parë i ODIHR-it kërkon kryerjen pa vonesë të reformës. Kjo është e paprecedent. Qeveria socialiste nuk ka vullnet për të zhvilluar zgjedhje me

standarde, sepse nuk do të fitonte në kushtet e korrupsionit, kriminalitetit dhe trafiqeve ?galopante të drogës. Në këto kushte, forcimi i monitorimit nga kjo Asamble e nderuar është themelor për rikthimin e bazave të demokracisë në Shqipëri.

planin veprimi që kemi adoptuar me Komisionerin Hahn. **Shqipëria ka qenë prodhuesi më i madh i kanabisit në Europë, vitet e fundit. Tani shumë plantacione janë shkatërruar, por policët janë përfshirë shumë në tregtimin e kanabisit. Çfarë do të bëni rreth kësaj?**

Kjo është një çështje e mbyllur, nuk ka një problem real me këtë. Rezultatet e monitorimit do të tregojnë në fund të muajit, se kanabisi është zhdukur nga toka e Shqipërisë. Ka vetëm disa pika të vogla, shumë më pak sesa kultivohet në vende të tjera të Europës. Është bërë e zakonshme të flitet për "krimin shqiptar", por kjo është raciste.

Policët të përfshirë në trafikun e drogës nuk janë ndjekur penalisht. Autoritetet e hetimit ndërkombëtar kanë konfirmuar se ka një problem.

Unë kurrë nuk kam thënë se s'ka pasur problem. Ka të bëjë se mbi çfarë imajinate krijohen opinio-

net. Kam lexuar një raport të BE-së mbi korrupsionin dhe kishte shumë që janë më të larta se Prodhimi Kombëtar Bruto. Prandaj le të flasim seriozisht. Kishte një problem para se ne të hynim në qeveri dhe ne kemi deklaruar luftë kundër drogës.

Pas shkatërrimit të plantacioneve në Lazarat, u përhapën më shumë plantacione kanabisit...

Kjo nuk është e vërtetë! Ju duhet të kuptoni diçka shumë të thjeshtë. Deri në vitin 2015, të gjitha deklaratat e policisë ishin sekrete, pra, jo publike. Ne i kemi publikuar ato, më pas prandaj njerëzit kanë folur më shumë rreth kanabisit. Por, në qoftë se shkon në arkivat e para vitit 2013, do të shikoni se ka pasur kanabis kudo. Është qoftë se do të vërtetën, unë të them të vërtetën. Në qoftë se doni të qendroni me imagjinatën tuaj, qëndroni me imagjinatën tuaj.

Ka edhe një ligj, i cili është i diskutueshëm, është për importimin e plehrave. Kryetari i ri

i parlamentit, Gramoz Ruçi, ishte ministër i Brendshëm në vitin 1991, kur 4 vetë u vranë në demonstratë në Shkodër. A po bëhen hetime brenda partisë tuaj socialiste për atë kohë?

Kjo është hetuar dhe gjykuar në gjykatë dhe është liruar nga të gjitha akuzat e çmendura. Pse duhet që partia të hetojë tani për këtë? Unë jam për një kohë të gjatë lider i kësaj partie. Unë kam qenë edhe lider i lëvizjes antikomuniste. Kjo Parti Socialiste që unë drejtoj nuk ka asnjë lidhje me të kaluarën.

Megjithëse ai ka qenë ish-ministër i Brendshëm...

I cili ishte ministër i Brendshëm në periudhën e tranzicionit, saktësisht pas revoltës. Ai ka vepruar në mënyrë të shkëlqyer, sepse ai organizoi zgjedhjet e para të lira dhe të drejta si ministër i Brendshëm dhe në këto zgjedhje, presidenti komunist humbi zgjedhjet. Pjesa tjetër janë thjesht broçkulla dhe nuk e kuptoj se si mund të diskutohet në 2017-ën, kur ne kemi miratuar ligjin

që lejon publikimin e të gjitha dosjeve nga koha e komunizmit, kemi punuar për rreth 1 vit me Gjermaninë për këtë propozim. Ne kemi hapur "Shtëpinë e gjeteve" dhe muzeun e bunkerit të komunizmit, në mënyrë që njerëzit të trajtojnë të kaluarën, dhe ne i kemi paguar kompensim të gjithë ish-të përndjekurve politikë që janë gjallë. Dhe tani ju më thonë mua ish-ministër i Brendshëm?!

Po, sepse ai është simboli i asaj kohe. A ka diskutime në partinë tuaj për këtë?

Jo, sepse partia është shkëputur prej tyre kohë më parë dhe ai nuk është simbol i asnjë gjëje. Ai është vetëm objektivi i një opozite barbare, e cila kërkon vetëm të demonizojë njerëzit. Një numër i madh shqiptarësh e respektojnë atë shumë, sepse ai ka treguar integritet dhe ka reformuar partinë, dhe unë jam i kënaqur që parlamenti tani punon si një parlament dhe jo si një klub të dehurish - si pak muaj më parë.

HOROSKOPI

DASHI
Bashkëveprimi i planetëve do të bëjë që humori i juaj të ketë luhajtje. Mos u mbyllni brenda vetes. Pranoni dhe besojuni të tjerëve. Për të arritur në një mirëkuptim më të madh, vëreni veten në vendin e partnerit dhe bëni më të mirën që mundeni.

DEMI
Edhe pse dini të manovroni më së miri duke u mbështetur në vetvetë, mos e refuzoni ndihmën që do ju ofrohet nga një mik. Do të kërkonti dhe do të gjeni, me Marsin dhe Venusin që ju mbështesin, mundësi dialogu dhe bashkëpunime me personin e dashur.

BINJAKET
Do të jeni të frymëzuar për të mposhtur çdo mendim shkatërrimtar, do të përvishni mëngët dhe do të përbushni me zell punët tuaja. Në fillim kush ju intereson do t'i përgjigjet ftesës me droje, por më pas do të dorëzohet nga sharmi i juaj.

GAFORJA
Me Saturnin që e keni kundra, mos flisni shumë në ambientin e punës. Mos krijoni konfidenca. Mundohuni të mos tregoni sesi ndiheni. Por, mos u ndruni dhe thoni ato që ju thotë zemra, edhe pse keni frikë se personi i dashur përkaq jush mund të mos ju kuptojë.

LUANI
Të papritura të këndshme në familje. Përditshmëria do të jetë më emocionuese dhe e këndshme, edhe pse do t'ju ndodhë që të ndryshoni menjëherë programin. Do të jeni në lartësinë e duhur për të marrë vendime shumë delikate. Do të fitoni këshill vlerësimin e një eprori.

VIRGJERESHA
Keni shumë pritshmëri ndaj një personi që ndoshta nuk do të tregohet në lartësinë e duhur. Do të ishte më mirë të përqendroni vëmendjen diku tjetër. Mos u bëni kokëfortë! Keni dëshirë të madhe të imponoheni në të gjitha rrethanat. Do të ishte mirë që të mendoheshit pak.

PESHORJA
Nëse në jetën e në çift xhelozia dhe dyshimet do t'i kalonin nivelet e normales, jepini fund kur të mundeni dhe ndërroni menjëherë drejt. Plutoni nuk shkon mirë me Saturnin! Humori jo i mirë do të pengojë bashkëpunimin me një koleg.

AKREPI
Partneri më në fund do të jetë në lartësinë e duhur që kërkon situata dhe nuk do të shqetësohet nga përgjigjet që do t'ju jepni kërkesave që ka. Nëse do të zgjidhni të jeni më emocional, do të jeni më pak bujar dhe të përfshirë, por sigurt dhe të qetë.

SHIGJETARI
Sot mund t'ju dalin gjëra të paparashkueshme. Për të shmangur tensionet, ndiqni atë që ju thotë zemra, edhe pse mund të interpretohet si një dobesi. Sot do të jeni të prirur drejt dembelizmit, por që nuk pajtohet me angazhimet tuaja të shumta.

BRICJAPI
Disa kërkesa për pushtet në çift nuk funksionojnë, hapni rrugë. Nëse do të jeni më mirënjohës, rezultatet nuk do të vonojnë të vijnë. Mos u merrni me gjëra që hanë diskutim. Duke këmbëngulur do ta kuptoni se e keni pasur gabim.

UJORI
Nëse keni programuar një udhëtim, do ta menaxhoni më mirë lodhjen dhe përshatjen ndaj ritmeve më të mëdha të punës, falë Plutoni mik që ju favorizon. Kridhuni në ndonjë aventurë të bukur, zbuloni një horizont të ri dhe jetojeni me gjithë shpirt.

PESHQIT
Ditën e sotme përpiguni ta shfrytëzoni mirëqenien shpirtërore për të degjuar më shumë dhe për t'i kushtuar më shumë kohë familjes. Me Saturnin që ju del kundra, priten disa përgjigje që ndoshta mund t'ju kufizojnë disi lirinë.

Lamtumira e një legjende, Kapitani luajti 93 ndeshje kuqezi

Lorik Cana: Kombëtarja bashkoi të gjithë shqiptarët

Lorik Cana është shfaqur i emocionuar para kamerave, në pritje për të shkëlmuar topin e fundit para ndeshjes Shqipëri-Itali. "Më vjen keq që "Tifozat Kuq e Zi" nuk do të jenë në stadium, po besoj edhe atyre ju vjen keq. Janë pjesë e pandarë e Kombëtares, pasi kanë themeluar grupin e parë të tifozëve. Ata përfaqësojnë çdo vlerë, me shqiptarë nga të gjitha trevat. Megjithatë, jemi sqaruar për këtë mungesë. Unë lamtumirën nuk mund ta



zgjasia kaq shumë", - ka thënë Cana për "TVSH". "E ardhmja? Nuk është prioriteti im të bëhem trajner. Do shoh të marrë një projekt, për të qenë drejtues në një klub. Djali? Të bëj çfarë ka dëshirë, unë do ta

mbështes. Nëse është për të zgjedhur një sport, do t'i thoshja të bëhej tenist". Loriku mori një ofertë "live" për të qenë në TVSH si analist. "Patjetër, kur të kem ndonjë ftesë, do të vijë".

Tifozët reagojnë për mungesën në ceremoninë e lamtumirës

TKZ: Na fal Kapiten, por na detyruan të mos jemi

"Tifozat Kuq e Zi" nuk do të jenë prezent për t'i dhënë lamtumirën kapitenit legjendar të Kombëtares, Lorik Cana, për shkak të bojkotit pa afat në ndeshjet që Shqipëria luan brenda. Njëpër një postimi në faqen e "Facebook", "TKZ" i kanë kërkuar falje Lorikut që nuk do të jenë në stadium për të thirrur edhe një herë emrin e tij. "Faleminderit Kapiten! Të na falësh që nuk do të jemi aty të thërrasim edhe një herë



emrin tënd sot siç kemi bërë për vite me rradhë në të gjitha stadiumet e Europës. Na fal, por na detyruan! Je dhe do të mbetesh përgjithmonë Kapiteni ynë. Faleminderit për gjithçka! Shi-

hemi së shpejti! Ps. Tash të presim edhe në tribuna ta përkrahim Kombëtares së bashku! #Faleminderit Kapiten #LorikCana5," lexohet në postimin e TKZ-së.

Shqipëria luan mirë, por nuk ia del të thyejë Bufonin. Italia na ndëshkon në të 73-ën

Mëkat! Na ndëshkon arbëreshi Kandreva

Kuqezinjtë zhvilluan një ndeshje të madhe

Jeton Selimi



Një gol i arbëreshit Antonio Kandreva u ka mjaftuar italianëve që të dalin duarplotë nga Loro Boriçi i Shkodrës, ndërsa duhet theksuar se katër herë kampionët e botës kanë vuajtur jo pak përballë Shqipërisë së drejtuar nga Krsitian Panuçi. Kuqezinjtë tanë kanë zhvilluar një ndeshje vërtet të mirë, por Roshi e Grezda nuk mund të bënin dot asgjë përballë një ikone si Xhanluixhi Bufon, që në disa momente reagoi mjaft mirë duke shpërtuar portën e të kaltërve nga goli i Shqipërisë. Në Loro Boriçin e tejmbushur, tifozët kanë shpresuar se mund t'ia dilnin përballë Italisë, por një hutim në zonën e Berishës në minutën e 73-të, i dha mundësi Kandrevës që të shënojë golin e fitores. Italia me këtë rezultat do të jetë kokë grupi në shortin e ardhshëm, ndërsa Shqipëria ruan vendin e tretë

në grupin B, pasi Izraeli u mposht nga Spanja.

Shumë ndryshime në formacionin e Panuçit që propozonte një 4-2-3-1 sulmues, Veseli përkrah Mavrajt dhe jo Ajeti në mbrojtje, riktheheshin Agolli në mbrojtje dhe Sadiku në sulm. Këmbëngulte te 4-2-4 Ventura dhe në Loro Boriçi sinjalin e parë e jep një shkodran që luan në Itali, Elseid Hysaj. E nis vullshëm Shqipëria që në të 10 provon edhe më një të djathtë të bukur të Grezdes me Buffon që arrin ta kthejë topin edhe pse jo pa vështirësi. I karikuar Christian Panuçi kundër Italisë, skuadër me të cilën ka luajtur 57 ndeshje. Të kaltërit bëhen të rrezikshëm në minutën e 21 kur Veseli shikon veten në vështirësi në një krosim të gjatë për Immobilen që gjuan por Berisha është aty për t'i vënë gjoksin topit. Në të 27 provon goditjen e befasisë Armando Sadiku që spostohet drejt qendrës dhe gjuan por përgjigjet Bufon. Menjëherë më pas provon të njëjtin gjë edhe Eder. Ventura shikon Italinë e tij të fiket disi me kalimin e minutave. Të kaltërit gjithse-



si kërkojnë një penallti në minutën e 40 për prekje me dorë në zonë nga Veseli por loja vazhdon për norvegjezin Svein Oddvar Moen. Pas një krosimi nga thellësia Imobilen gjuan pjesën e jashtme të rrjetës së Berishës dhe pjesa e parë mbyllet me rrjeta të paprekura.

E dyta fillon me një rast për Shqipërinë përpara Roshi provon me një goditje të bukur por ja del të kthejë me

grushta Buffon. Minutat në vijim Italianët fitojnë metra, me Shqipërinë që organizohet mirë në mbrojtje, në të 59 Kandreva gjuan në diagonale jashtë. Menjëherë më pas të kaltërit kanë një kundërsulm të favorshëm por Eder finalizon keq. Provon edhe Insignje në të 62 me Berishën që është gati. Pak sekonda më vonë Eros Grezda shikon që ka hapësirë dhe lëshon një goditje potente me topin që

merr trajektore të pazakontë duke vënë në vështirësi serioze edhe një si Buffon. Është një Shqipëri që ka luajtur vërtet mirë, por ndëshkohet në të vetmin gabim që bën, atë të minutës së 73 kur Spinazzola nga e majta krosin për Kandrevën, me topin që kalon gjithë mbrojtjen dhe gjen interstin të lënë vetëm. Nuk fal lojtari me origjinë arbëreshe dhe 1-0.

Italia në avantazh, është një goditje e papritur për Shqipërinë, me Panuçin që në të 76 fut Latifin me Memushajn, nuk vonon të tregojë klasin prishitinaliu me një krosim të bukur që e detyron Chiellin të rrezikojë autogolin. Në goditjen e këndit menjëherë më pas Roshi ka në këmbë një rast të artë por vonohet me goditjen e tij që devijohet. Shqipëria provon të bëjë dikë me shumë përpara por rrezikon të pësojë sërish në fund kur kapet e papërgatitur pas, me Berishën që fiton në duelin një për një me Immobilen. Përfundon 1-0, pikërisht ajo që ju duhej italianëve që i gëzohen suksesit, ndërsa Shqipëria i mbyllë eliminoret me një barazim të ikur nga duart në Loro Boriçi.

HEROI I NDESHJES



Kandreva: Tani mendojmë për fazën play-off

Mesfushori i Italisë, Antonio Kandreva, i cili realizoi edhe golin e fitores së Italisë ndaj Shqipërisë ka folur shkurtimisht pas ndeshjes. "Vinim nga një rezultat jo pozitiv ndaj Maqedonisë dhe fitorja sot (dje) na shërben. Gjithsesi jam i kënaqur për rezultatit e sotëm (dëshëm), dhe tashmë po mendojmë për fazën e Playoffit", tha Kandreva

SULMUESI MORI FANELLËN E BUFFONIT

Sadiku: E vështirë të kaloje Bonuçin dhe Kielinin

Armando Sadiku, pas humbjes së Shqipërisë 0-1 kundër Italisë u shpreh: "Luajtëm si të barabartë ndaj Italisë. U ndëshkuam nga një episod, të cilin mund ta evitonim. Në këtë gjithçka për të shënuar, por nuk ia dolëm. Ishim pak konfuzë në metrat e fundit, sepse e kërkuam



golin, por pa saktësinë e duhur. Ishite e vështirë për të luajtur

ndaj dy qendërmbrojtësve të gjatë si Bonuçi dhe Kielini. U mundova t'i kapja pas shpine, por ishte e pamundur. Bonuçi dhe Kielini merrshin vesh shumë mirë me njëri-tjetrin dhe finisin shumë mes tyre gjatë ndeshjes. Ishin në unision. Fanellën e Bufonit? E mora unë në fund të ndeshjes. Ia kërkoja kur isha pranë portës gjatë një goditjeje këndi dhe ma dha pas ndeshjes. Bufon është një legjendë", tha Armando Sadiku për RTSH.


BATUTA

Tavekio i jep fanellën e Kandrevas, Rama: Unë jam me Juventusin!

Gjatë ceremonisë së ekspozitës së katër Kupave të Botës të fituara nga Italia në teatrin "Migjeni" në Shkodër, presidenti i Federatës së Futbollit të Italisë, Tavekio i dhuroi kryeministrit të Shqipërisë, Edi Ramës, fanellën e Italisë, pikërisht atë të Antonio Kandrevas, lojtarit me origjinë arbëreshe që luan për të kaltërit. Pasi falënderoi Tavechion për dhuratën, kryeministri Rama tha me batutë: "Ky është lojtari i Interit, unë jam me Juventusin. Megjithatë po e marr, edhe pse më rri pak e vogël, duket. Le ta mbajë djali im".



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Parafjalë prejardhjeje.
3. I përshtatshëm.
7. Eshhtë sportive në garë.
11. Fidel që thirret Lider Maximo
13. Para Jack në flamurin britanik.
14. Rodrigues që këndonte fado.
16. Një pjesë e lartësisë.
18. Vende pa ne.
19. I është hequr të dënuarit.
20. Ishte miku i famshëm i Orestit.
22. Pak enigmatike.
23. Janë pasuri të investuara
25. Një pjesë e simpoziumit.
26. U përmbysën në Afganistan.
27. Inicialet e Moravia-s.
28. Ai B prek mëlçinë.
29. Vritet në fund.
31. Manchester i Alex Ferguson.
33. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.

35. Eshhtë zëri... i hekurit.
37. Ai B është rezervë.
39. Shkroi Një jetë e Jezusit.
41. Eshhtë për medaljen e parë.
42. Papas aktore.
45. Thomson aktore.
47. Tri të parat në atletikë.
49. Kështu thirrej Marco Pantani.
50. Dhanë alarmin në kapitot

VERTIKAL

1. Bëhet në stacion.
2. Eshhtë irritimi.
3. Argento aktore.
4. Detarë pa erë.
5. Në krye të armatës.
6. Janë si meduza.
7. Mbeten në bisht.
8. Eshhtë gjendja e të martuarit.
9. Pesci aktor.

10. Kulmojnë më Akonkagua.
12. Një Baba përrallor.
13. Janë priftërinj
15. Më e pakta.
17. Rrëzon padinë një e tillë.
20. Ishin kalorësoit si Rolandi.
21. Poggi aktore.
23. Një mund të jetë republike.
24. Një material inert për çati.
26. Janë ushtarakë të ulët
28. Para parade në diskografi.
30. Trimi pa çifte.
32. E ardhmja më e afërt.
34. U vra në banjë nga Corday.
36. Një mund të jetë pushimi.
38. Një lloj njeriu.
40. Janë tek në numra.
43. Fund janari
44. Fillojnë nazet.
46. Mbyllin portat.
48. Nota e diapazonit.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Harris aktor.
3. Termocentrali i shkurtër.
5. Organizata me koska.
10. Një tufë bagëtish.
12. Inicialet e Redford.
14. Kështu thonë se bëhet ai që mërëzitet.
15. Scarlet e Bashkë e erën.
17. Elvira aktore.
19. Eshhtë Panorama që ke në dorë.
21. Ushtojnë nga "ola".
22. Shtet aziatik.
24. Eshhtë ministri.
25. Në radhtë të parë.
26. G... për njerëzit e FBI.
27. Makina Micra.
31. Mund të jetë proteste.
32. Pasur pa kufij.
33. Gjika e Dora d'Istria.
36. Të fundit në dhjetor.


37. Kush është nuk tutet.
38. Njën bilete njëmjore.
39. Një zakon i keq.
41. Pak imoralitet.
42. Dhjetë angleze.
43. Të parat në ambient.
45. Mund të jenë kuzhine.
48. Magritte piktor.
50. Janë tipat... tipografikë.
51. Tutorë pa zë.

VERTIKAL


1. Umberto që shkroi Baudolino.
2. Bertë këngëtare italiane.
3. Fillojnë një temë.
4. Një garë në hipodrom.
6. Oe burri i parë.
7. Një ndriçues.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. I dha fillin Tezeut.
10. Vihen për të mbyllur
11. Para Saint-Germain në futboll.
13. Qëllon në një vend.
16. Eshhtë dosja e të pandehurit.
17. Janë përmasat
18. Mbush në kufij.
20. I bëjnë duart me ar.
21. Inicialet e dali piktor.
23. Fillojnë argumentin.
28. Makina Ibiza.
29. Emri i Einstein.
30. Ndrriçojnë rrugët.
31. Kim që që aktore.
32. I hedh i dorzuar.
34. Inicialet e Nolte aktor.
35. Ishin rapsodët e akeje.
37. Fund shkurti.
40. Van der portier holandez.
44. Fillojnë masat
46. Inicialet e Rohmer.
47. Fillojnë teorikisht.
49. Numër i shkurtër.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

AR K A M A R S H P R T
 K A O S I M W K U R A
 S H E N D E T I A N E T
 A T A T E L E F O N A T
 R T E N I S T E T H A
 K U V E R T A T R I T E T
 N E R V I T S E L
 A R A S M A T R O N A
 R E V O L T A N E E S O N
 K T R E E D G D C R T
 A T I T A R E M A M I
 T A K T E M I L Y R A K

FJALËKRYQI (1)

Argëtim filozofik

Argëtim filozofik



Chënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

A R I K T A P I N V A
 B E S N I K U A R R E S T
 A D M A T E R I A L L
 T R I M E R I T E D E
 P A R A K A L I M F A T
 A L I T E R A G I O N I
 T I M E H V L I K
 E E A S T O A T I L A
 N N T K A L E P I A
 T E S A R A J E M I R O
 A E M R I K A P A K E T
 T O T T A M A R A A T I

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	2	1		8	9			
9			5	6		2	1	
4	3		8					
		6			8		2	7
	4		9		7		5	
8	2		4			3		
				5		7	6	
	6	9		3	1			4
7		5		9	1			


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	2	5	7	4	8	1	3	6
8	3	4	1	6	2	5	9	7
1	6	7	5	9	3	4	8	2
6	5	9	2	8	7	3	4	1
3	8	2	4	1	5	6	7	9
7	4	1	9	3	6	8	2	5
2	7	8	6	5	4	9	1	3
4	9	6	3	2	1	7	5	8
5	1	3	8	7	9	2	6	4

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



G A T I T A L E N T I
 A R A M P A F T E R R
 R E T H E P A T I T E T
 G S H E R E T I K E
 A K O M I T E T E T M
 M E K I P E T T M A
 E I C N E T K A P A K
 L I G C S T I L E
 L R S W I N G S I T
 A O P A T E N T A T
 M A Y E O R A R I
 G Y P I P O L I T I K

- Ka diferencë të madhe midis pëlqimit dhe dashurisë.. Nëse të pëlqen një lule e këput menjëherë, ndërsa kur e do e 'ujit' dhe përkujdesesh për të gjithmonë. **Populli**
- Fëmijet gjejnë gjithçkanë në asgjë, kurse të rriturit asgjenë në gjithçka! (**Giacomo Leopardi**)
- I dua njerëzit që kanë mbetur në jetën time, ma bënë jetën të mrekullueshme, i falënderoj edhe njerëzit që u larguan nga jeta ime, ma bënë jetën fantastike...
- Në botë ka njerëz që kanë para... dhe njerëz që janë të pasur...

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

